

Peleshi: Bonuse për specialistët e mbrojtjes kibernetike në shtet

FAQE 2



Konferencë shkencore në Akademinë e Shkencave

“100 vjet nga lufta e Dibrës”

Trajtohet për herë të parë në nivel akademik lufta heroike 9-vjeçare kundër pushtuesve serbë

Nga Halil RAMA –Mjeshtër i Madh



FAQE 2

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI TË POPULLIT SHQIPTAR



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 1(403)

JANAR 2022 ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtör: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

U KREMTUA 90-VJETORI I REVISTËS “MBROJTJA”

MM: “Çertifikatë Mirënjohje” për gjeneral Parllakun

OBVL, HISTORI SUKSESI EDHE NË 2021

Halil RAMA

• Si iniciatore e krijimit të Federatës Shqiptare të Veteranëve, OBVL ka fuar publikisht dy organizatat e veteranëve të LANÇ të Shqipërisë dhe Kosovës që të bëhen pjesë e kësaj Federate, duke ruajtur secila logon dhe fizioniminë e vet. Për këtë jemi të hapur për bisedime për të konkluduar në një platformë të përbashkët, duke i paraprirë kështu bashkimit kombëtar aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e dy shteteve tona dhe të hapësirës mbarëshqiptare në botë

FAQE 3



Në këtë ceremoni festive, ku mori pjesë zv/ministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, u vlerësua me “Çertifikatë Mirënjohje” edhe zv. kryeredaktori i gazetës “Veterani” Z. Sakip Cami, publicist dhe shkrimtar i mirënjohur



78-VJETORI

Konferenca e Bujanit për bashkimin e kombit shqiptar

Dr. Qemal LAME

FAQE 5

REFERATI

Dukuri të artit ushtarak të shfaqura në Luftën e Dibrës 1920-1921

Nga Prof. Dr. Bernard ZOTAJ

FAQE 6-7

HISTORIA

78 vjet më parë – Operacioni i madh armik i Dimrit 1943-1944

FAQE 4

PORTRET

MIRJAN HOXHA, DËSHMOR I POLICISË SË SHTETIT

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 8

OPINION

VERIU I KOSOVËS, FITIL BAROTI PËR RAJONIN

BASHKIM HISARI

FAQE 11


PROFIL

NIKOLL BROZI, I THJESHTË GJER NË MADHËSHTI

FAQE 9

LIBRI

Kujtim Boriçi dhe Nuri Çuni, një libër me vlera për apostullin dhe bilbilin e shqiptarizms



NAIM FRASHËRI, PROFETI I BASHKIMIT RRETH ATDHEUT

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 11

AKTUALITET

Peleshi: Bonuse për specialistët e mbrojtjes kibernetike në shtet



Siguria kibernetike po bëhet çdo ditë e më shumë një fushë që kërkon fuqi punëtore të specializuar, ndaj ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si drejtues i institucionit që shumë shpejt do të marrë drejtimin për garantimin e mbrojtjes kibernetike përsëritet pjesëmarrësit në aktivitetin inovativ “Cyber Camp Albania”, ku ftoi të rinjtë të orientojnë karrierën e tyre drejt kësaj fushe.

Ministri Peleshi vuri në dukje rrezikun që u kanoset shpesh institucioneve shtetërore dhe joshetërore nga sulmet kibernetike, jo vetëm në Shqipëri, por në SHBA, ku, siç tha ai, në çdo 39 sekonda ka një sulm të tillë. Shembuj ka edhe për ndërhyrjen përmes këtyre sulmeve në procese elektorale, apo në infrastrukturën kritike të shteteve.

Duke sjellë edhe përvojën e Izraelit, ku ministri Peleshi ishte për vizitë zyrtare pak ditë më parë u shpreh: “Kjo do të thotë që ka nevojë për talente, ka nevojë për fuqi punëtore, për njerëz të kualifikuar. Sot në botë ka miliona vende pune bosh në fushën e zhvillimit të software-ve dhe aq më tepër në fushën e Mbrojtjes Kibernetike. Unë isha para disa ditësh në Izrael e, vetëm në Tel Aviv kishte 17 mijë vende pune, të cilat nuk mbusheshin dot, sepse nuk i gjenin dot në treg. Janë miliona vende pune në botë, të cilat presin talente dhe për këtë arsye këto fusha janë nga fushat më të paguara, profesionet më të paguara”. Sipas z. Peleshi, “Ministria e Mbrojtjes do të punojë bashkë me Agjencinë e Certifikimit Elektronik të Mbrojtjes Kibernetike për të bërë politikën e mbrojtjes kibernetike, standardet, rregullat e zbatueshme nga të gjitha ato institucione të cilat janë pjesë e infrastrukturës kritike

që domosdomërisht duhet të kenë të zhvilluara kapacitetet e mbrojtjes kibernetike”. Ai tha se gjithçka fillon nga edukimi dhe sot janë 16 studentë që fillojnë Masterin e Mbrojtjes Kibernetike pranë Akademisë së FA, ndërsa po punohet për të shtuar mundësitë e kualifikimeve, trajnimeve në këtë fushë. “Kështu që krahas bachelorit në sistemin e arsimit privat, apo shtetëror do të shtojmë dhe do të mbështesim, do të subvencionojmë me një program të posaçëm qeveritar edukimin dhe trajnimin e shpejtë në fushat për të cilat po flasim pra: kodim, programim, mbrojtje kibernetike. Mundësitë janë të jashtëzakonshme. Ne kemi një fond për mbështetjen e njëmijë apo dy mijë koduesve, ose të rinjve, që duan të kualifikohen dhe të bëhen kodues, apo të punojnë në të gjitha fushat e IT, këto si subvencion, pra për të paguar burimet e tyre. Kemi disa kompani shumë të mira që janë në kontakt me qeverinë dhe do të jenë aplikues të këtij fondi”, u shpreh ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se kryeministri ka dhënë dritën jeshile për të shtuar pagesën me bonuse për specialistët e kësaj fushe në administratën shtetërore, duke i barazuar këto paga me tregun privat.

Aktiviteti inovativ “Cyber Camp Albania” është konceptuar si një aktivitet vjetor, i cili do të organizohet me dy edicione (dhjetor dhe maj) të çdo viti akademik, për të theksuar rëndësinë e edukimit dhe orientimit drejt profileve të sigurisë kibernetike të të rinjve në fazat e hershme të studimit në njërin anë dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë në fushën e sigurisë kibernetike dhe krimit kibernetik në nivel kombëtar në anën tjetër.

Zëvendësministria Bici në Ministerialin Paqeruajtjes të OKB



Në datat 7-8 dhjetor 2021, në Seul u zhvillua Ministeriali i Katërt Paqeruajtjes i Kombeve të Bashkuara. Ku u diskutua mbi paqeruajtjen e Kombeve të Bashkuara. Ministeriali u realizua në variant të përzier, nëpërmjet prezencës fizike dhe me video-konferencë, si rezultat i situatës të pandemisë të shkakton nga COVID-19. Folësit në këtë Ministerial trajtuan sfidat kryesore të paqeruaj-

jtjes, duke përfshirë ministrat e Punëve të Jashtme dhe atyre të Mbrojtjes, paqeruajtjes aktualë dhe të mëparshëm, si dhe të ftuar specialë.

Delegacioni i Republikës së Shqipërisë u përfaqësua në ministerial me video-konferencë nga Ministria e Mbrojtjes, kryesuar nga zëvendësministria Dallëndyshe Bici dhe nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, kryesuar nga zëvendësministri Megi Fino.

Bazuar në politikën e jashtme të Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kontribuojnë aktivisht në fushat e ruajtjes dhe forcimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, mbrojtjes dhe promovimit e të drejtave të njeriut, si dhe çarmatimit dhe mospërhapjen e armëve. Lidhur me angazhimet në kuadër të OKB, Forcat e Armatosura kanë kontribuar me trupa ushtarake në UNOMIG (Operacioni në Gjeorgji), MINURCAT (Misioni në Republikën e Afrikës Qendrore dhe Chad) dhe UNMISS (Misioni në Sudanin e Jugut).



Konferencë shkencore: “100 vjet nga lufta e Dibrës”

Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Njëqint vjet më parë, Ismail Strazimiri, protagonist i rendit parësor në vendlindjen e tij në Dibër e në gjithë Shqipërinë, shprehte shqetësimin për mospasqyrimin me vërtetësi nga historiografia e kohës, të luftës heroike 9 - vjeçare të Dibrës kundër pushtuesve serbë.

Njëqint vjet më pas, këtë të vërtetë historike të pamohueshme e argumentojnë shkencërisht akademikë, profesorë të historisë, studiues e historianë të njohur. Më së miri kjo u konkretizua në Konferencën Shkencore “100 vjet nga lufta e Dibrës”, që u organizua më 20 dhjetor 2021 nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Historisë Ushtarake dhe Shoqatën “Çidhna dhe Kastriotët”.

Akademik Skënder Gjinushi, duke përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera tha se: “Lufta e Dibrës qe një luftë popullore, që shfaqti të njëjtat ndjenja e veprime atdhetare si dibranët që kishte në krah themeluesi i shtetit shqiptar Ismail Qemali: dom Nikollë Kaçori e Vehbi Dibra. Figura të tilla si Elez Isufi e Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, Jashar Erebara, Osman Paci, janë të përmasave kombëtare dhe meritojnë nderimin tone”. Më pas, përshëndeti Mustafa Tola, kryetar nderi i shoqatës “Çidhna dhe Kastriotët” i cili falënderoi Akademinë e Shkencave dhe organizatorët për konferencën që përkujton këtë ngjarje epokale, jo vetëm për historinë e Dibrës, por për gjithë shqiptarinë.

Konferenca u mbajt në dy seanca. E para u drejtua nga akad. Pëllumb Xhufi, prof.asoc.dr.Bernard Zotaj dhe shkrimtari i mirënjohur dibran Xhafer Martini. Seanca e dytë u drejtua nga akad. Marenglen Verli dhe prof. dr. Adem Bunguri.

Sipas një programi me pasuri të gjerë tematike, në 19 referate e trajtesa u evidentuan ngjarjet, priijësit, heronjtë dhe aspekte organizative e taktiko-luftarake të kësaj lufte legjendare.

Akad. Pëllumb Xhufi e vlerësoi Luftën e Dibrës si një nga hallkat kryesore të lëvizjes për pavarësimin e Shqipërisë në përgjigje të kundërveprimeve për ndarjen dhe përcaktimin e kufijve nga Fiqitë e Mëdha, ndërkohë që Serbia po zgjeronte planet e saj për

pushtimin e trojeve shqiptare.

Prof. dr. Paskal Milo foli për aspektin diplomatik të rezistencës dhe luftës së dibranëve kundër ndërhyrjes dhe pushtimit jugosllav (1918-1921) dhe e konsideroi këtë moment historik si rizgimin kombëtar, ndërkohë që forcat serbe mbanin në vitin 1918 të pushtuar krahinat verilindore si dhe ato të Dibrës së Poshtëme, me pozicione të avancuara deri në Qafën e Buallit, e Qafë Murrë, Hasin, Lumën, Malësinë e Gjakovës, Krasniqen e Kelmendin.

Prof. Milo tha se ndërkohë që Serbia po ngrinte administratat e saj në trevën e Dibrës, kjo luftë frenoi vendosjen e regjimit jugosllav në Shqipëri. “Pa rezistencën e luftën heroike të luftëtarëve dibranë, as Lidhja e Kombeve, as Fuqitë e Mëdha nuk do t'i detyronin forcat serbe pushtuese të largoheshin nga Dibra. Lufta e Dibrës 100 vite më parë ishte akti i fundit i luftës për sigurimin e unitetit territorial të shtetit shqiptar. Ishte vijimi dhe pëmbysja e një procesi historik kombëtar që nisi me Kongresin e Lushnjës, vazhdoi me luftën e Vlorës e përfundoi e luftën e Dibrës.”, -tha Milo.

Interes të veçantë ngjalli tek të pranishmit trajtesa e prof.dr.Bajram Xhafës: “Pse zgjati 9 vjet lufta e Dibrës”, ndërsa akademik Shaban Sinani foli për luftën e Dibrës sipas Ismail Strazimitit.

Të tjera kumtesa vijuan nga prof. dr. Adem Bunguri për barbarizmat serbe në Dibër në vitet 1913-1921; akad.Marenglen Verli për qëndresën kundër pushtuesve serbë në vitet 1912-1913; prof. asoc. dr. Bernard Zoto që foli për dukuri të artit ushtarak në Luftën e Dibrës; shkrimtari Xhafer Martini u përqëndrua tek personaliteti i Elez Isufit; dr. Sali Kadria për profilin e nacionalizmit shqiptar në kontekstin e Luftës së Dibrës; dr. Dritan Murrja për krijimin e prefekturës së Drinit për mbajtjen e zgjedhjeve; Haki Pernezha për luftën e Çidhnës në vitet 1912-1921; Zabit Lleshi për betejën në Grykën e Vogël kundër serbëve në vitet 1912-1921 dhe Ali Hoxha për disa aspekte nga kryengritja e shtatorit 1913.

Konferenca pati jehonë të jashtëzakonshme për faktin se lufta heroike 9 vjeçare e Dibrës kundër serbëve, për here të pare u trajtua dhe promovua në nivel akademik.

SPECIALE

Ngjarje e shënuar për OBVL gjatë vitit 2021 ishte mbajtja e Kuvendit të jashtëzakonshëm Kombëtar më 22 maj

OBVL, histori sukcesi edhe në 2021

Halil RAMA

- Si iniciatore e krijimit të Federatës Shqiptare të Veteranëve, OBVL ka ftuar publikisht dy organizatat e veteranëve të LANÇ të Shqipërisë dhe Kosovës që të bëhen pjesë e kësaj Federate, duke ruajtur secila logon dhe fizioniminë e vet. Për këtë jemi të hapur për bisedime për të konkluduar në një platformë të përbashkët, duke i paraprirë kështu bashkimit kombëtar aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e dy shteteve tona dhe të hapësirës mbarëshqiptare në botë

Për OBVL dhe strukturat e saj në qendër e në bazë, viti 2021, ishte një histori sukcesi. Megjithatë vështirësitë e krijuara nga zgjatja e pandemisë COVID-19, OBVL përbushi objektivat e planifikuara. Një punë intensive kanë bërë veteranët e organizatave të rretheve e në qendër, për përbushjen e detyrave e objektivave, që u ngarkonin platforma e programi,



aprovuar nga Kuvendi i jashtëzakonshëm Kombëtar i OBVL i datës 22 maj 2021. Nga ky kuvend u përcaktua si objektivi parësor përkujtimi e ndriçimi i ngjarjeve historike, të luftërave për liri e pavarësi kombëtare, në veçanti të Luftës Nacionalçlirimtare, me qëllim që t'ua bëjmë me dije brezit të ri të sotëm e t'ua lëmë trashëgim brezave që vijnë këto ngjarje të lavdishme të historisë së popullit tonë. Në përbushje të këtij ob-

jekti OBVL u fokusua në përkujtimin e figurave të shquara, që kanë lënë gjurmë të pashlyera si udhëheqës e drejtues të këtyre luftërave; në veçanti për përkujtimin e komandantëve e drejtuesve të Luftës Nacionalçlirimtare që çlirojnë atdheun 78 vjet më parë.

Kështu u organizua përkujtimi i 105-vjetorit të lindjes së komandantit legjendar të Brigadës së IV-t Nexhip Vinçani, të cilin, me propozimin tonë

Presidenti i Republikës e dekoroi me titullin e lartë "Nderi i Kombit". Me këtë titull të lartë në përvjetorët e ditëlindjeve jubilarë të tyre janë dekoruar më parë edhe dy ish-kryetarët e OBVL: Dr.Ymer Dishnica e gjeneral Rrahman Parllaku, duke e bërë kështu OBVL-në një nga OJF-të më të vlerësuara nga kreu i shtetit. Kjo edhe për faktin se këto pesë vitet e fundit janë vlerësuar me "Dekorata e Artë e Shqiptarëve" edhe ish drejtues të tjerë të OBVL, si ish-kryetari kolonel Myfit Guxholli, ish-sekretari i Përgjithshëm Edip Ohri si dhe Znj.Liri Belishova. Po ashtu dy vitet e fundit janë dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin "Mjeshtër i Madh", Sekretari i Përgjithshëm i OBVL Z.Halil Rama dhe nënkryetari, Z.Muharrem Gjoka.

Këto dekorime ia kanë rritur prestigjin OBVL, duke e inkurajuar atë të progresojë në përbushjen e programit të saj.

Një ngjarje e shënuar për OBVL gjatë vitit 2021 ishte mbajtja e Kuvendit të jashtëzakonshëm Kombëtar më 22 maj, pas ndarjes nga jeta të ish-kryetarit Myfit Guxholli, kontributi dhe veprimtaria e të cilit u vlerësua pothuajse nga të gjithë pjesëmarrësit në këtë kuvend.

Nën drejtimin e kryetarit të ri, kolonel Sotir Budina, OBVL intensifikoi veprimtarinë e saj, sidomos në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës.

OBVL është anëtare e Federatave Europiane e Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen në aktivitetet e këtyre Federatave, jo vetëm në Europë, por edhe në Azi e Afrikë, ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II Botërore dhe të luftërave për liri të shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që japin sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s.

Si iniciatore e krijimit të Federatës Shqiptare të Veteranëve, OBVL ka ftuar publikisht dy organizatat e veteranëve të LANÇ të Shqipërisë dhe Kosovës që të bëhen pjesë e kësaj federate, duke ruajtur secila logon dhe fizioniminë e vet. Për këtë jemi të hapur për bisedime për të konkluduar në një platformë të përbashkët, duke i paraprirë kështu bashkimit kombëtar aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e dy shteteve tona dhe të hapësirës mbarëshqiptare në botë.

Të gjitha këto aktivitete kanë gjetur pasqyrim të gjerë në gazetën tonë "VETERANI" e cila i ka shpalosur ato me saktësi e vërtetësi para lexuesve.

NDERIMI

U kremtua 90 vjetori i revistës "Mbrojtja"

Kryetari i Nderit i OBVL, gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, si dhe zv.kryeredaktori i gazetës "Veterani" z. Sakip Cami vlerësohen me "Çertifikatë Mirënjohje"

Me datë 15 dhjetor 2021 në sallën e Muzeut të Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e 90 vjetorit të revistës "Mbrojtja". Kjo veprimtari u organizua nga Qendra e Kulturës, Mediave dhe Botimeve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ishin ftuar të gjithë gazetarët ushtarakë ndër vite. Mori pjesë edhe zv.ministria e MM znj. Dallëndyshe Bici.

Për veprimtarinë e shtypit ushtarak ndër vite që nga viti 1931 kur doli num-



ri i parë i revistës ushtarake dhe deri më sot folën historianët ushtarakë Sali Onuzi, Zaho Golemi dhe Bernard Zotaj, Kumtesat e tyre u shoqëruan me një ekspozitë fotografike dhe nga një diapozitiv me foto dhe emrat e gazetarëve ndër vite. Pjesëmarrësit bënë homazh për gazetarët që nuk jetojnë më, si Lirim Deda, Hysni Millosi, Apostol Duka, Halil Katana, Vasil Gjylameti, piktori Kosta Raka, poeti Arben Duka etj.


Për shumë nga gazetarët, redaktorët, bashkëpunëtorët, kryeredaktorët, shkrimtarët dhe poetët ushtarakë u

shpërndanë Çertifikata Mirënjohje nga Zv.ministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, drejtoresha e Qendrës së Kulturës, Mediave dhe Botimeve znj. Mirela Roshii, zv.drejtori Jakin Marena dhe shefja e sektorit të botimeve Anjeza Musollari.

Gazetarët e pranishëm falenderuan organizatorët për zhvillimin e kësaj veprimtarie të bukur. Më pas të pranishmit i vazhduan bisedat dhe kujtimet e tyre në një koktej.

Përgatiti: Sakip Cami

Zv.kryeredaktor i gazetës "Veterani", ish redaktor i gazetës "Ushtria"



HISTORI

Faqe të lavdishme nga lufta heroike e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

78 vjet më parë – Operacioni i madh armik i Dimrit 1943-1944

Në fundin e vitit 1943, Ushtria Nacionalçlirimtare ishte rritur e forcuar dhe godiste pa pushim armikun. Në këtë kohë, e favorizuar dhe nga kushtet e jashtme si fitoret e Ushtrisë Sovjetike dhe të Aleatëve, Ushtria Nacionalçlirimtare kishte çliruar edhe mjaft qytete si Dibra, Peshkopia, Kruja, Berati, Gjirokastra dhe harta e territoreve të çliruara po shtrihej deri në Vlorë. Po rrezikoheshin rrugët e Lëvizjes së Ushtrisë Naziste. Kjo gjendje e shqetësonte shumë komandën gjermane. Në këto kushte, kryekomandanti i forcave naziste gjermane deklaronte: “Deri tani ne i kemi besuar mikpritjes dhe besës shqiptare, por nuk mundemi të durojmë më gjatë sulmet; duhet të marrim masa për sigurinë tonë”. Në të njëjtën kohë, qeveria tradhtarë e Tiranës, u vu drejtpërdrejt në shërbim të okupatorit dhe mobilizoi forcat e veta për të asgjësuar forcat partizane. Gjermanët iu vunë punës për përgatitjen e një operacioni ushtarak të përgjithshëm në Shqipëri. Qëllimi i këtij operacioni synonte asgjësimin e UNÇL dhe shkatërrimin e këshillave Nacionalçlirimtare, për të vendosur pushtetin e bashkëpunëtorëve të tyre.

Forcat naziste gjermane që vepronin në Shqipëri u përforcuan me forca të tjera të ardhura nga Greqia e Jugosllavia dhe që hynin në përbërjen e katër divizioneve gjermane (297, 181, 21, 104.) Efektiviteti i këtyre forcave armike arrinte rreth 30.000 veta, përveç afro 12.000 forca të Ballit Kombëtar e Legalitetit. Komandanti i Përgjithshëm i Operacionit ishte gjenerali nazist Fehm.

Ndërsa forcat e UNÇL arrinin rreth 20.000 luftëtarë; shumica e tyre të inkuadruar në batalione, grupe e brigade të rregullta (4 brigada, 9 grupe dhe 17 batalione). Armatimi i tyre ishte i thjeshtë: pushkë automatike, mitraloza të lehtë e të rëndë. Burimi kryesor i furnizimit të forcave partizane me veshmbathje, ushqim dhe municion ishte populli ndërkohë që llogaritej edhe furnizimi nga aleatët dhe kapja në luftë e depove dhe materialeve të ndryshme të armikut. Ajo kishte moral shumë të lartë dhe disiplinë të shëndoshë e të ndërgjegjshme sepse partizanët luftonin për një gjë të shenjtë, çlirimin e atdheut. Komanda gjermane, pasi kishte përpunuar planin e operacionit dhe kishte bërë përgatitjet e nevojshme filloi nga zbatimi i tij qysh në Nëntor 1943 duke sulmuar UNÇL në zonën e Pezës dhe pastaj me radhë në zonat e Dibrës, Mallakastrës, Çermenikës, Shëngjergj-Martanesht, Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe Kurvelesh-Salari-Mesaplikut. Pas disa goditjeve të vogla, komanda gjermane nazifashiste, kolaboracionistët e armatosur deri në dhembë goditjen kryesore e dhanë kundër forcave të Brigadës së 3-të dhe Grupit të Pezës. Forcat armike sulmuan nga drejtimet: Tirana, Ndroqi, Shijaku, Kavaja, Rrogozhina e Peqini me qëllim rrethimin dhe asgjësimin e forcave partizane. Këto të fundit, megjithëse të armatosura me armë të lehta, pa ushqime dhe veshmbathje, në kondita dimri luftuan me trimëri të rrallë.

Shtabi i Përgjithshëm, duke vlerësuar rezistencën e armikut vendosi që Brigada e 3-të të kalonte në zonën e Çermenikës duke manovruar për të çarë rrethimin. Në të njëjtën kohë, Grupi i Pezës u urdhërua të luftonte me grupe të vogla kundër forcave armike të dislokuara në zonën e Pezës. Ushtria nazifashiste mundi të përshkonte zonën e Pezës gjatë operacionit. Këtu ajo dogji, vrau e shkatërroi, por partizanët e Pezës nuk mundi t'i asgjësonte.

PARTIZANËT I ZBATUAN MË PËRPIKËRI DETYRAT

Pas operacionit të Pezës, okupatorët nazistë kryen sulme kundër forcave partizane të Dibrës e Peshkopisë. Edhe këtu partizanët luftuan me trimëri, por në pamundësi manovrimi në ato zona, detashmentet partizane në kondita të disfavorshme karshi armikut marrin urdhër për tu tërhequr dhe të kalonin në drejtim të Shqipërisë së Mesme e të Jugut. Njëkohësisht edhe zona e Tropojës nuk shpëtoi nga operacioni duke u sulmuar nga forcat gjermane dhe ato të Xhafer Devës, të cilat pasi e shkelën, e dogjën, plaçkitën popullin, arrestuan dhe rrahën në gjithë zonën e Malësisë.

Operacioni në krahinën e Mallakastrës u krye me forca të mëdha. U pushtua Berati dhe u vazhdua për në drejtim të Mallakastrës ku ishte përqendruar një pjesë e madhe luftarake e UNÇL për atë kohë, Brigada I Sulmuese. Forcat gjermane në bashkëpunim me ato kolaboracioniste sulmuan në drejtim të



Fierit e Beratit. Në Gllavë sulmuan forcat kolaboracioniste së bashku me ato naziste gjermane. Pra, forcat partizane ishin të rrethuara nga të gjitha anët. Mjaftonte një gabim i vogël dhe forcat partizane të asgjësoheshin. Komanda e Brigadës I Sulmuese, nën drejtimin e shokut Mehmet Shehu e vlerësoi drejt situatën dhe mori vendimin për të dalë nga rrethimi që po i përgatiste armiku. Partizanët zbatuan me përpikëri detyrat dhe duke përdorur Lëndën e Vogël të Memaliaj kaluan lumin Vjosë për në krahinën e Mesaplikut. Në operacionin e krahinës së Mesaplikut e të Kurveleshit të Poshtëm, forcat e Brigadës I Sulmuese dhe ato të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastrë zhvilluan luftime të përgjakshme, duke i shkatëruar humbje të mëdha armikut në Vajzë, Gjorm e Qafa e Shëngjergjit. Forcat partizane, duke mos dashur të angazhoheshin në luftime të gjata frontale përpara një armiku superior në forca e mjete, me një manovrim të shpejtë u tërhoqën nga pozicionet e para dhe zunë vijën Bolenë-Vranisht duke zhvilluar luftime të rrepta. Njëkohësisht ato kaluan në zonën e Kurveleshit të Sipërm. Më vonë, forcat kryesore të Brigadës manovruan në zonën e Zagorisë e Lunxhërisë. Një pjesë e tyre u bashkuan me forcat partizane të Qarkut të Vlorës duke kaluar prapa krahëve të armikut për tu kthyer përsëri në Mesaplik e Kurvelesh duke pastruar këto zona nga kolaboracionistët dhe armiku nazist.

ÇARJA E RRETHIMIT NË MALET E MARTANESHIT E ÇERMIKËS

Në 15-ditshin e dytë të Dhjetorit 1943, forca të shumta naziste gjermane dhe kolaboracioniste filluan operacionin kundër forcave partizane që vepronin në zonën Çermenikë-Shëngjergj-Martanesht. Para se të fillonin operacionin bënë disa goditje kundër partizanëve dhe përforcuan pozitat e tyre gjatë rrugës automobilistike Qafë e Thanës-Elbasan-Tiranë. Qëllimi i armikut ishte që forcat partizane të Brigadës 2-të e 3-të, si dhe batalionet e Çermenikës e Martanesht të mbeteshin të izoluara dhe të asgjësoheshin. Me këto forca partizane ndodhej edhe Shtabi i Përgjithshëm. Ishte rasti që Shtabi i Përgjithshëm të tregonte më së miri organizimin e këtyre luftimeve kundër forcave të shumta armike të armatosura më së miri. Ai duhej të grumbullonte forcat e dy brigadave, asaj të 2-të e të 3-të si dhe të batalioneve të Martaneshtit e Çermenikës në një komandë të vetme dhe të luftonin duke sulmuar e mbrojtur që të mund të çanin rrethimin. Por Shtabi i Përgjithshëm, sidomos Enver Hoxha vetë i katërt vendosi të largohesh në Jug të vendit, në zonën e Polisit. Ndërsa forcat partizane u lanë në dorë të shtabeve të tyre duke rrezikuar edhe shpërbërjen. Këto forca partizane luftuan me trimëri dhe vetëmohim për të çarë rrethimin dhe me manovër të shpejtë arritën të shpëputeshin nga forcat gjermane dhe ato kolaboracioniste. Humbjet e këtyre forcave, sidomos të Brigadës së 2-të ishin shumë të mëdha. Forcat e Brigadës së 3-të kaluan në zonën e Matit e Lurës dhe më vonë në atë të Pezës ndërsa forcat e Brigadës së 2-të kaluan në zonën e Tiranës e Krujës. Veprimet luftarake të forcave partizane në operacionin e Shëngjergj-Martanesht-Çermenikës, si rrjedhojë i një vlerësimi jo të drejtë të situatës nga Shtabi i Përgjithshëm me Enver Hoxhën në krye u

shoqëruan nga një humbje e madhe e forcave partizane dhe nga një imazh i keq. Pas këtyre goditjeve të vogla në të gjitha qarqet e vendit, më 7 janar 1944 filloi Operacioni Armik i Dimrit, njëherësh në zonën e Korçës, Elbasanit e Beratit. Armiku synonte ti shtynte forcat partizane sa më në Jug, t'i rrethonte dhe ti asgjësonte ato. Brigada e 4-të luftoi me trimëri e heroizëm në vijën e frontit....- Voskopojë-Gjergjevicë dhe nuk i lejoi forcat gjermane të përparonin. Ndërsa në zonën e Beratit, në drejtim të Tomorricës dhe nga Elbasani armiku mundi të përparojë dhe arriti në Mazrekë të Oparit. Kjo dalje vuri në rrezik forcat e Brigadës së 4-të e cila me një manovër të shpejtë çau rrethimin duke kaluar në Qafën e Beçit (Mali Ostrovicë) dhe kaloi në Potom (Skrapar). Gjermanët pushtuan Tomorricën, Sulovën, Nahijën e Beratit, Gorën dhe Oparin duke kryer një terror të paparë nëpër fshatra me synimin për të shpëputur nga lufta masat e popullit. Tentativa e armikut ishte që të dilte nga Çorovoda në Tendën e Qypit për në Përmet. Forcat partizane të Qarkut të Beratit dhe sidomos forcat e Brigadës së I-rë luftuan heroikisht në Tendën e Qypit duke arritur që ti ndalojnë dhe ti detyrojnë të tërhiqen gjermanët. Një ndihmë të madhe dhanë dhe forcat partizane të Brigadës së 6-të që sapo ishte formuar në Përmet.

Gjermanët kudo që shkuan dogjën, vranë dhe plaçkitën por nuk ia arritën qëllimit për të shpartalluar Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Armiku po të njëjtin operacion bëri edhe në Qarkun e Vlorës kundër Brigadës së 5-të e cila u rrezikua seriozisht, por manovrimi i saj dhe ndihma e popullsisë bëri që ajo, jo vetëm të çante rrethimin, por ta godiste armikun në befasi.

MËSYMJA E PËRGJITHSHME E UNÇL

Kur nazistët gjermanë dhe kolaboracionistët po i jepnin fund operacionit në pamundësi të asgjësimit Ushtrinë Nacionalçlirimtare shqiptare, forcat e UNÇL u hodhën në mësymje: Brigada e 5-të në Qarkun e Vlorës, Brigada e 4-të në Qarkun e Korçës, Brigada I Sulmuese në Qarkun e Beratit, Brigada e 6-të në zonën e Lunxhërisë e Zagorisë. Kështu ata i dhanë goditje të fortë armikut dhe filluan të çlironin të gjitha zonat që kishte pushtuar ai gjatë operacionit.

Përballimi me sukses i Operacionit të egër Armik të Dimrit '1943-1944 ka qenë prova më e rëndë për UNÇL shqiptare dhe për popullin shqiptar. Në luftime të ashpra në kushte të pabarabarta, në një dimër jashtëzakonisht të vështirë humbjet e partizanëve ishin mbi 1000 veta por radhë e UNÇL shqiptare u shtuan dhe u forcuan, ndërkohë u rrit besimi i popullit në fitoren mbi pushtuesin. Gjatë Operacionit Armik të Dimrit u çimentua dashuria dhe besimi i patundur i luftëtarëve të lirisë për detyrën e lartë të çlirimit të Atdheut..., u rrit ndërgjegjja dhe përkushtimi i partizanëve për një organizim të përsosur, manovër të shkëlqyer e disiplinë të lartë të UNÇL. U rrit në shkallën më të lartë besimi i popullit tek Ushtria Nacionalçlirimtare si e vetmja forcë që do ta çlironte vendin nga pushtuesit gjermanë.

**Sipas kujtimeve të Myfit Guxhollit, ish – nenkryetar dhe kryetar i OBVL*

78-VJETORI



Dr. Qemal LAME

Konferenca e Bujanit për bashkimin e kombit shqiptar

- ***Kujtojmë Konferencën e Bujanit, për të reflektuar në problemet madhore të bashkimit kombëtar dhe të vlerësimit të drejtë të situatave politike me të cilat përballen shqiptarët. Bashkimi i Shqiptarëve mbetet problemi themelor që kërkon zgjidhje nga politika shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri, si dhe vlerësim e mbështetje nga partnerët strategjikë***



gosllavisë, Josip Broz Tito ka deklaruar për agjencinë amerikane "Associated Press", se "Nëse komunistët vijnë në pushtet në Shqipëri, ajo (Kosova) mund të jetë nën juridiksionin e Tiranës."

2. Josip Broz Tito i ka premtuar Enver Hoxhës, në vitin 1946, se do t'i kthente Kosovën dhe territore të tjera shqiptare që ndodheshin në Federatën Jugosllave. "Kreu i shtetit shqiptar, Enver Hoxha gjithmonë ka deklaruar publikisht se marshalli Tito i ka premtuar në fund të qershorit të vitit 1946, se Kosova dhe territore të tjera me shumicë shqiptare do të jenë pjesë e Shqipërisë."

3. Në bazë të të dhënave të publikuara më vonë, edhe dora e djathtë e Titos, Edvard Kardel, me rastin e vizitës së tij në Moskë, i kishte thënë Stalinit se Kosova do t'i jepet Shqipërisë, me luftën e tyre kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij.

Këto dëshmi janë të pasqyruara edhe në qëndrimet e mbajtura nga media jugosllave dhe ajo serbe. Ato janë komentuar si dëshmi për kritikën ndaj Titos dhe mbështetjen e politikës shoviniste serbe për pushtimin dhe ligjërimin e gjenocidit ndaj shqiptarëve. Gazeta serbe "Pravda" shkruan se Tito, në vitin 1946 për pak sa nuk i ka "dhuruar" Hoxhës Kosovën dhe Metohinë, por edhe territore të tjera shqiptare. Pak e njohur është për botën, kur ish-udhëheqësi jugosllav kishte thënë hapur se: "Kosova dhe territore të tjera me shumicë shqiptare do t'i kthehen Shqipërisë." Konferenca dhe rezoluta e Bujanit, ruajnë me të drejtë vlerat historike si një ngjarje e rëndësishme nga Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare, në të cilën u shpreh e drejta e shqiptarëve për vetëvendosje dhe për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Ëndrra shumë shekullore e shqiptarëve për bashkim, u kthye në një dramë me epilogun tragjik të gjenocidit të shovinistëve serbë ndaj shqiptarëve, pushtimit të Kosovës dhe aneksimit të Shqipërisë si Republikë e shtatë e Jugosllavisë që dështoi vetëm në çastet e fundit për shkak të qëndrimit të kundër të Bashkimit Sovjetik. Është e nevojshme të vëmë në dukje, se në këtë dokument është reflektuar edhe mendimi politik dhe ideologjik në bazë të parimeve të internacionales komuniste, dominimit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë ndaj Partisë Komuniste të Shqipërisë, si dhe

niste shqiptaro-jugosllave, vendosën regjimin e një shtettrrethimi dhe të gjendjes së luftës, dhe nën pretekstet e shfaqjes së "kundërrevolucionit", ushtruan terrorin e gjenocidit për aneksimin e Kosovës, eliminuan të gjitha forcat patriotike që luftuan për bashkimin me Shqipërisë. Në Drenicë u vranë mijëra shqiptarë. Pranimi i së "drejtës për vetëvendosje" do të imponohej si një "deklarim për bashkim e Kosovës me Serbinë"! Formula ideologjike e bashkimit shqiptar, e inspiruar nga Konferenca e Bujanit, vazhdoi të shfaqej edhe në vitet gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë e deri vonë me kërkesën për Republikën e Kosovës. Legjitimiteti politik i pavarësisë dhe procesi i shtet-ndërtimit të Kosovës, do të merrte rrugëzgjidhje me Luftën e Kosovës, më 1998, dhe do të përmbyllej me Deklaratën e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të Kosovës, më 17 shkurt 2008. Kujtojmë Konferencën e Bujanit, për të reflektuar në problemet madhore të bashkimit kombëtar dhe të vlerësimit të drejtë të situatave politike me të cilat përballen shqiptarët. Bashkimi i Shqiptarëve mbetet problemi themelor që kërkon zgjidhje nga politika shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri, si dhe vlerësim e mbështetje nga partnerët strategjikë. Integrimi euro-atlantik mbetet orientimi strategjik për mbrojtjen e kombit dhe realizimin e vullnetit politik të së drejtës së vetëvendosjes e të bashkimit në shtetin e përbashkët, ashtu si edhe popujt e tjerë. Arritja e kësaj sfide, kërkohet të dëshmohej edhe në vështirësitë që ndeshen nga vazhdimësia e politikës shoviniste të Serbisë, imponimin e hapur ose të manipuluar me planet e fshehta për ndarjen e Kosovës, propagandës për të pranuar zgjidhje të dhimbshme e të domosdoshme për arritjen e marrëveshjes historike midis shqiptarëve e serbëve.

Periodha e Luftës së Dytë Botërore, mbetet koha e marrjes së vendimeve historike në Luftën kundër nazi-fashizmit, ku shqiptarët u bashkuan me Aleancën e Madhe Antifashiste dhe realizuan çlirimin me forcat e tyre të Shqipërisë, kontribuan edhe në Kosovë e në Jugosllavi deri në Vishegrad, si dhe dëshmuuan edhe vullnetin për bashkimin kombëtar.

Konferenca e Bujanit, e mbajtur më 31 dhjetor 1943 e deri me 2 janar 1944, është një nga ngjarjet madhore të periudhës së lavdishme të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, ku u dëshmuua vullneti politik për realizimin e së drejtë së ligjshme të shqiptarëve për vetëvendosje dhe për bashkim e Kosovës me Shqipërinë. Konferenca e Bujanit bëri rikonfirmim i qëndrimit të shqiptarëve ndaj rrethanave të reja të krijuara pas Mbledhjes së Mukjes, si dhe rezultat i mospërfshirjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën sundimin e ish Mbretërisë SKS, (Konferenca e Bujanit), e cila u mbajt pikërisht për t'i kundërshtuar vendimet e Mbledhjes II të AVNOJ-it në Jajcë (29-30 nëntor 1943) dhe mos përfshirjes së Kosovës si subjekt i pavarur që deri atëherë ishte përfaqësuar përmes Malit të Zi në KACKJ-së. Konferenca e Bujanit përfundoi punimet e saj me një rezolutë të miratuar unanimisht, ku thuhet: "Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është një anë, e cila popullohet në pjesën më të madhe nga popullsia shqiptare, e cila, si gjithmonë, dëshiron edhe sot të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj, e ndiejmë për detyrë ta vëmë në dukje rrugën e vërtetë në të cilën duhet të ecë populli shqiptarë për të realizuar aspiratat e veta. Rruga e vetme për t'u bashkuar me Shqipërinë, për shqiptarët e Kosovës dhe të Rrafshi i Dukagjinit, është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë".

Formulimi i këtij qëndrimi politik, mbështetjet në vetë deklaratat e PKJ-së dhe të KANÇ-it të Jugosllavisë, në të cilat njihet parimi i vetëvendosjes së popujve deri në shpallje, parim bazë ky i Kartës së Atlantikut, i shpallur solemnisht nga aleatët e koalicionit antifashist. Në rezolutë theksohej se:

Lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist e rrogëtarëve të tij, është e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosje mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shpallje. Garant për këtë është UNÇ i Jugosllavisë dhe UNÇSH i Shqipërisë, me të cilën është ngushtësisht e lidhur. Përveç këtyre, për këtë garantojnë aleatët tanë të mëdhenj, Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit). Është e domosdoshme të njihet e të mos harrohet fakti se vetë Tito është shprehur për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

1. Në vitin 1946, Udhëheqësi i ish-Ju-



REFERATI

100 VJET NGA LUFTA E DIBRËS – KONFERENCË SKENCORE NË DUKURI TË ARTIT USHTARAK TË SHFAQURA

Prof. Asoc. Dr. Beranrd Zotaj

LUFTA E DIBRËS NË SFONDIN HISTORIK

100-vjetori i Luftës së Dibrës shënon një ngjarje të madhe përkujtimi, por dhe zhvillim të vlerave të historisë e të traditës tonë kombëtare. Festimi i këtij jubileu nuk është thjesht një ceremonial, apo një borxh nderimi për paraardhësit tanë dhe veprën e tyre. Është më tepër se kaq. Lufta e Dibrës e cila u zhvillua për liri, pavarësi dhe sovranitet, u jetësua në betejat popullore të luftëtarëve në Nëntë Malet e Dibrës, kundër një ushtrie të huaj e të organizuar me ambicje të njohura pushtuese ndaj Dibrës dhe Buqizës që ndodhej në “vijën strategjike”, dhe në saj të vendimmarrjes së burrave të shquar dibran, bëri të mundur dhe ja zbardhi faqen Shqipërisë, duke mundur një mbretëri dhe Fuqi të Mëdha që qëndronin pas saj.

Në Luftën e Dibrës morën pjesë pothuajse të gjitha forcat e grupet shoqërore të popullsisë. Lufta mori karakterin e një lufte balllore, që dëshmonte për ndryshime në përmasa, në organizim të veprimeve luftarake, si dhe të disa dukurive të shfaqura të artit ushtarak shqiptar. U krijua kështu një front i gjerë lufte kundër ushtrisë serbe, që përbënte dhe tiparin kryesor të saj.

Në udhëheqje të Luftës së Dibrës dolën përfaqësues të patriotizmit, njerëz fisnikë, të kamur në pa-suri, drejtues të organizimeve ushtarake, klerikë, si dhe atdhetar të qytetit dhe të fshatit.

ÇETAT ISHIN BASHKIME TË LUFTËTARËVE

Në Luftën e Dibrës u manifestua shpirti luftarak i luftëtarëve, por dhe i popullit patriot të saj. Zg-jimi i masave popullore të fshatit dhe të qytetit në vitet 1918-1920 ishte një nga dukuritë kryesore që i dhanë Luftës së Dibrës karakter luftarak dhe rritje të frymës patriotike. Nga pikpamja e organizimit ushtararak, formacionet luftarake, çetat ishin bashkime të luftëtarëve të fshatrave dhe të krahinave me lidhje të përkohshme dhe me përbërje të thjeshtë. Një fshat ose lagje qyteti formoi një çetë prej disa dhjetra luftëtarësh deri në ndonjë rast edhe mbi njëqind. Në vartësi të numrit të shtëpive (familjeve), një krahinë formoi disa çeta, të cilat bënë një forcë të madhe me luftëtarë.

Lufta e Dibrës edhe pse me një brumë njerëzor, jo ushtarak, por vullnetarë (luftëtarë) ka zënë një vend në studimin e Artit Ushtarak Shqiptar. Dukuritë lidhen me njëri-tjetrin. Ato janë sa ushtarake aq dhe politike, të brendshme dhe ndërkombëtare. Në këto kushte para popullsisë dibrane dilte nevoja që të organizonte rezistencën e armatosura. Deri tani gjithë veprimtaria ishte kufizuar në kundërshtimin me armë të armikut në fshatrat Arras, Vajkal e Steblevë si rezultat i së cilës u konkretizua një Vijë fronti në Dibër të Poshtme që nga Ura e Dodës e deri te Ura e Topojanit për së gjati lumit Drin i Zi, në Bulqizë për së gjati Zallit të Murës e deri te Kulla e Shabës, kurse në Gollobondë për së gjati Zallit të Okshtunit e në Shkallë bë Borovës, në pritje të çastit të përshtatshëm për t'u hedhur në sulm.

TIPARET QË U MANIFESTUAN GJATË ORGANIZIMIT

Tipar dallues i Luftës së Dibrës ishte masiviteti dhe vullnetarizmi. Fshatarët u organizuan në çeta siç ishte çeta e katundit Vajkal e komanduar nga Mehmet Duriçi, që ruanin territorin ditë e natë dhe kundërshtonin përpjekjet e armikut për të kapërcyer kufirin strategjik. Përpjekjet e bëra prej serbëve në zonën e Gollobordës për të zënë Qafën e Dërstitles, mbi fshatin Zabzum, përsuan disfatë të plotë përballë qëndresës së forcave shqiptare.

Parimi i pjesëmarrjes ose i mobilizimit për luftë ishte vullnetarizmi që mbështetej në zakonet dhe traditat popullore, sipas të cilëve “çdo derë” (shtëpi) nxirrte nga një luftëtar. Çdo njësi e banuar, fshat, lagje qyteti, krahinë etj., do të nxirrte çetën e grupit të vet me një numër përafërsisht të përcaktuar luftëtarësh. Zakoni po merrte formën e detyrimit të pakundërshtueshëm. Mobilizimi i forcave kryengritëse u bë mbi baza vullnetare. Patriotët dibranë, me qëndrim në Tiranë, sidomos deputeti Ramiz Daci, patrioti Ramiz Dibra etj., iu drejtuan qeverisë së Tiranës e kërkuar që të bëhej organizimi i administratës civile të prefekturës së Dibrës. Kështu nga fundi i muajit korrik 1920 në fshatin Arras të Peshkopisë u vendos administrata e krahinës me prefekt Ramiz Dibrën.



Administrata e vendosur mbante lidhje me krahinat e pushtuara dhe bënte përgatitje për luftën e armatosur. U arrit të lidhej një “besë e përgjithshme” në të gjithë krahinën që gjithë vëmendja të drejtohej kundër pushtuesit.

Si rregull para nisjes së luftës mbledhej një kuvend krahinor ose ndërkrahinor i cili shpallte vendimet dhe përcaktonte qëllimin dhe etapat përkatëse të luftës, masat organizative, detyrat, numrin e forcave dhe detyrimin për çdo fshat e krahinë, zgjidhte prijësat apo drejtuesit e luftës. Autoriteti i Këshillit të Prefekturës u rrit shumë. Krahas tij u krijua dhe komanda ushtarake nën drejtimin e Elez Isufit. Kjo komandë mori në shqyrtim dislokimin e forcave armike dhe caktoi zonën e luftimeve për çdo repart fshatarësh në sulm ose në prapavijë të armikut. Ushtria serbe që vendosur në pikat më dominuese të krahinës. Të gjashtë batalionet e vendosura në Dibrën e Poshtme, shtabin kryesor e kishin në Kodrat e Llasenit, në jug të Peshkopisë. Forcat ushtarake ishin shpërndarë në këto vende: në Majë të Llogorit, te Lisat e Trenës, në Smollaviç, në Kodër të Bullgarit, në Qafë të Kërnelit, që të gjitha në territorin e fshatit Dohoshishtë. Më nga veriu e nga verilindja ishin vendosur në Gjarica të Brezhdanit, në Kodër të Kabe, në Pasma të Kishavecit, në Ostësh të Laçes, në Kodër të Kshtejës të katundit Kastriot, në Salbatër të Fushalies, në Shkeka të Shumbatit dhe në Kala të Dodës.

STRATEGJIA USHTARAKE DHE ORGANIZIMI USHTARAK

Strategjia ushtarake e kësaj lufte e mbështeti dhe e përshtati organizimin ushtarak në traditën popullore luftarake të trashëguar duke i dhënë përm-bajtje bashkëkohore krijimit të çetave të fshatrave, të krahinave, si dhe të Komandës Ushtarake. Këto dukuri të thjeshta, mbështetur në frymën atdhetare të popullit ju përgjigjën forcave, mjeteve e mundësive në plotësimin e detyrave të rëndësishme luftarake. Ato siguruan shpejtësi në mobilizimin, lehtësi në veprimet taktike dhe mundësi për të përdorur metoda të luftës tradicionale dhe të luftës me front të rregullt, që kushtëzonte karakteri deri i fortifikuar i garnizoneve armike. Forcat kryengritëse nga fshati Arras më 13 gusht 1920 i dërguan një ultimatum komandës së ushtrive serbe ku kërkohej që brenda 24 orëve të tërhiqeshin në kufirin e 1913, por serbët nuk pranuan. Atëherë sipas planit të përpunuar që më parë, u vendos të sulmohej ushtria armike e përqëndruar në “Shkeka të Shumbatit” e pastaj në të gjitha vendet e tjera. Sulmi do të kryhej nga forcat

e Ujës e m’ujës dhe të Reç e Dardhës nën komandën e Suf Xhelilit, të cilëve do t’u shkonin në ndihmë forcat e Arrasit. Pozita natyrale favorizuese e Kodrinës së Shkekës ishte e tillë që paraqiste vështirësi shumë të madhe. Për të sulmuar malësorët nga çdo anë që të ndërmerrnin veprimin do të gjendeshin të zbuluar nën zjarrin e armëve serbe.

Ndërsa ushtria serbe ishte e fortifikuar në tran-she të thella, pozicionet (nozullimet) ishin futur në tokë dhe pozicionet kryesore ruheshin nga disa prita të avancuara në pararojë dhe praparojë të tyre. Në këtë pikë dominuese ishin vendosur dhe katër topa me rreze veprimi të gjatë. Marrja e kësaj pozite ishte vendimtare për kryengritjen, prandaj edhe sulmi i saj u studiua dhe u përgatit me shumë kujdes. Në radhë të parë u vendos që të sulmoheshin natën pikat e avancuara që kështu t’i afroheshin fshehurazi sa më shumë objektivit. Forcat e Ujës e M’ujës, nën komandën e vetë Suf Xhelilit zunë postën serbe në katundin Shumbat duke i sulmuar në befasi; ata doli kështu pa as më të voglën zhurmë Shkekës në verilindje. Forcat e Reç Dardhës likuiduan postën në krah të Zall Kalisit dhe iu afruan në heshtje Shkekës nga veriperëndimi. Ndërsa në mëngjes u dha sinjali i sulmit. Luftëtarët duke i mashtruar serbët me sulme fiktive, me britma të fuqishme “o besa besë” e me të shtëna me armë iu afruan shumë pozicioneve armike. Zjarri i armikut ishte shumë i dendur, si dhe terreni mjaft i disfavorshëm, megjithatë sulmuesit, nuk e ndalën përparimin e tyre drejt llogoreve armike.

Fill pas sulmit në Shkeka filloi edhe sulmi në Arras. Fshatarët e Çidhnës e një pjesë të Dardhës i udhëhiqte Elez Isufi. Sipas planit të vendosur të luftimeve, luftëtarët të veshur, kaluan lumin Drini i Zi dhe, nën goditjen e artilerisë serbe, përshkuan me vrap Fushalien dhe u ndanë në dy drejtime: një pjesë mësnyë Salbatrën, nën Shkeka të Shumbatit dhe një pjesë u drejtuan kah Ostushi në jug. Forcat që mësnyë Salbatrën me shpejtësi i detyruan forcat armike të tërhiqen dhe pastaj u drejtuan për në Shkeka. Ushtria serbe në Shkeka të Shumbatit bëri një qëndresë të dëshpëruar, por sulmi i fshatarëve dibranë që i rrufeshëm. Në shumë pika u kalua në luftim trup me trup me armikun brenda llogoreve të tij. Ushtrinë serbe e zu paniku dhe u vu në ikje pasi la mbi 1.000 vetë rob e të vrarë. Trimëri të jashtëzakonshme tregoi luftëtari Osman Tahir Paci, i cili ra dëshmor. Aktet heroike të luftëtarëve ngjallnin kurajo e mobilizim në radhët e fshatarëve.

Me sukses përfundoi edhe sulmi i forcave të Muhurrit dhe të fshatrave rreth Kastriotit kundër “Çapit të Brezhdanit” pas të cilit u pushtua “Gjan-

REFERATI

AKADEMINË E SHKENCAVE

në Luftën e Dibrës 1920-1921



ica". Armiku nuk u la i qetë dhe në prapavijat e tij. Forcat serbe në Kodër të Kabe u detyruan të tërhiqen në drejtim të Zimurit, ku u likuiduan plotësisht. Në këtë pritë u shqua luftëtari Melaim Kulemani, i cili vrau disa ushtarë dhe më në fund ra edhe vetë dëshmor i Atdheut.

Lufta e Dibrës dëshmoi edhe një herë vlerën morale se luftën nuk e fitojnë ata që kanë shumë armë, topa dhe vegla të luftës, Ushtria serbe, që ishte përqëndruar në Kodër të Pollozhanit, nën goditjen e fshatarëve, u detyrua të ikë drejt malit Skërtec, por u likuidua gati e tëra nga prita që i bëri fshati Rabisht.

Goditje e fortë ju bë ushtrisë serbe të dislokuar në afërsi të qytetit të Peshkopisë dhe veçanërisht shtabit serb në Kodrinat e Llasenit. Sulmin e filluan fshatarët e Dohoshishtit dhe të Grevës, dhe e vendosën armikun midis ry zjarresh. Në ndihmë të tyre shkuan edhe fshatarë të tjerë. Pas një lufte, që zgjati disa orë, serbët u tërhoqën në panik dhe lanë në duart e shqiptarëve topat, mitralozët dhe mjaft të vrarë e robër. Mësymja e armikut në Dibër të Poshtme u pasua nga sulmet kundër Vajkalit e Steblevës. Në fund të datës 15 gusht 1920 serbët u zbuuan përtej kufirit të 1913-s duke lënë disa qindra të vrarë, shumë robër, mjaft armë e municione, të gjitha topat, disa dhjetëra mitralozë, etj. Edhe pse armiku kishte ushtri e armatime të panumërta, forcat kryengritëse mundën të arrinin suksese, në radhë të parë, në sajë të vendosmërisë së tyre.

Nga ana taktike kryengritësit zbatuan me sukses sulmet e rrufeshme, goditjen natën, tërhoqën vëmendjen e armikut me sulme fiktive dhe vepruan njëkohësisht edhe në prapavijat e armikut, si brenda kufirit të 1913-s edhe jashtë këtij kufiri për qëllime zbulimi.

Kryengritësit shqiptarë vendosën lidhje me forcat e armatosura maqedone, të cilët kundërshtojnë politikën serbomadhe.

Pjesëmarrja masive e popullit në luftë ishte faktor vendimtar e më shumë rëndësi për suksesin në lëmin ushtarak. Menjëherë në qytetin e Peshkopisë u vendos administrata e prefekturës me Ramiz Dibrën në krye. Forca mbështetëse në një ushtri shumë të kufizuar dhe në gatishmërinë e fshatarëve kryengritës për të vazhduar luftën në mbrojtje të kufirit të 1913-s. Ndër detyrat më urgjente që i doli administratës ishte ruajtja e kufirit.

Këtë detyrë e morën përsipër vullnetarisht fshatarët duke u vendosur në pika të ndryshme. Administrata e prefekturës, për mungesë organizative, u gjend në vështirësi të mëdha për të përballuar situatën e re. Gjithashtu edhe Qeveria e Tiranës nuk kishte mundësi që të dërgonte forca ushtarake për sigurimin e kufirit.

Qarqet shoviniste serbe përgatitën forca të shumta ushtarake dhe nga fundi i muajit gusht 1920 sulmuan gjatë gjithë vijës së kufirit me mbi 40 batalione me ushtarë, të pajisura me armë nga më të rëndat që dispononin. Ushtritë serbe ndeshën me qëndresën e fshatarëve dhe sulmi armik u praps për tri ditë rresht. Disa qindra fshatarë, me pak fishekë, të vendosur që ta mbronin me çdo kusht kufirin e Atdheut, u bënë ballë heroikisht ushtrive të panumërta serbe.

PËRCAKTIM I DREJTIMIT TË GODITJES KRYESORE

Kryengritja e gusht-shtatorit e 1920-s e bërë nga populli i Dibrës kundër pushtuesit serb luajti një rol të rëndësishëm edukativ dhe mobilizues për periud-

hat e mëvonshme. Së pari, u rrënjos edhe më tepër te masat e popullit urrejtja për pushtuesin e huaj, i cili e tregoi fytyrën e vërtetë prej shtypësi e vrasësi. Së dyti, u shtua dhe u forcua edhe më shumë ndjenja e patriotizmit të masave të popullit. U forcua dhe u shtua edhe më shumë bashkëpunimi tradicional midis dibranëve dhe kosovarëve në luftë me të njëjtin armik. Së treti, spikati trimëria, guximi deri në vetëmohim dhe heroizmi masiv i malësorëve dibranë që në kushtet e pushtimit, pa marrë parasysh sakrificat në njerëz dhe në ekonomi, u përleshën me një ushtri të rregullt, të armatosur më së miri dhe në numër shumë herë më të madh. Së katërti, u provua dhe një herë aftësia luftarake dhe taktika popullore. Së pesti, u demaskua reaksioni vendas. Së gjashti, u hodhën poshtë akuzat falso të qarqeve të larta të borgjezisë serbe mbi "egërsinë" e dibranëve, të cilët, megjithëse kishin pësuar shumë në kurrizin e tyre, u sollën në mënyrë njerëzore ndaj të plagosurve dhe robërve duke i mjekuar ushqyer e përcjellë deri në destinacion. Së shtati, u bënë përpjekje, sado të kufizuara, për të bashkërenditur veprimtarinë me qarqet politike maqedone që vepronin kundër politikës serbomadhe, për mevetësinë e Maqedonisë. Së fundi, u bë e qartë për elementët e mashtruar, esadistë të Dibrës, se politika e serbëve ndaj Shqipërisë ishte një politikë armiqësore dhe çdo bashkëpunim i mëtejshëm me ta ishte në dëm të interesave kombëtare. Mësymja në përgjithësi filloi nga rajonet malore dhe u drejtua mbi garnizone dhe qendra të vogla, sipas vendimit të kuvendit, çetat dhe forcat luftarake u nisën në drejtimin e objektivit të mësymjes sikurse ishin përfordimet serbe. Luftëtarët ju afruan objektit në kolona marshimi dhe rreth 2 km pranë objektit të sulmit, ndalonin në vende të maskuara. Këtu pas njohjes me terrenin dhe objektivat, përcaktuan detyrën luftarake për luftim dhe kohën kalimit në sulm me sinjale. Sulmet zakonisht ishin rrethore dhe të vrullshme mbi garnizonin. Brenda ditës luftimet ishin të përfunduara dhe me fitore të forcave kryengritëse.

Mbrojtja zakonisht fillonte kur luftëtarët kishin kapur pozicione të rëndësishme taktike dhe deri operative dhe ishin afër rajoneve të fortifikuara. Mbrojtja e luftëtarëve u karakterizua gjithmonë nga manovra e shpejtë dhe krahëmbarrëse. Pikënisja e luftimeve ishte ndeshja në një vijë dhe pozicion të caktuar

terreni, ku luftëtarët organizuan mbrojtje, prita dhe kurthe.

Forcat kryengritëse kaluan në mësymje dhe duke realizuar objektivat operativë me metodat taktike, me goditje të njëpasnjëshme, e nga disa drejtime duke shfrytëzuar sistemin e mbrojtjes armike të përbërë nga garnizone të veçuara, me largësi ndërmjet tyre, si dhe përfituar nga karakteri i thyer i terrenit.

Çështja e furnizimit me ushqime e materiale të tjera luftarake ishte një ndër problemet e ndërlikuara që u zgjidhën në luftë e sipër. Duke vlerësuar kushtet e vështira të furnizimit, u përcaktua si e vetmen zgjidhje, mbështetja në forcat e çdo fshtai për çetën e vet. Burim kryesor i furnizimit u bënë fshatrat e Dibrës. Masa e gjërë e fshatarësisë, megjithëse mjaft e varfër vunë në dispozicion të forcave kryengritëse të gjitha sendet e nevojshme ushqimore, blegtorale e bujqësore e siguruan ndihma të konsiderueshme dhe për mjaft materiale të tjera. Gruaja dibrane ka lozur një rol të rëndësishëm në mbajtjen në këmbë të prapavijës si në gatimin e ushqimeve, por dhe në rregullimin e teshave të luftëtarëve, si dhe mjakimin dhe transportimin e luftëtarëve të plagosur etj. Burim shumë i rëndësishëm për furnizimi u bë dhe armiku, sidomos për armatim e municion. Sigurimi i armatimit duke ia rrëmbyer armikut në fushën e luftës, ishte një nga objektivat kryesorë të planit të komandës së forcave kryengritëse, veçanërisht gjatë fazës e parë të luftës, i cili u realizua me shumë sukses dhe i përmirësoi në mënyrë të ndjeshme kushtet e armatimit të Forcave Kryengritëse gjatë fazës së dytë të luftës.

Taktika e luftimit përdori forma e metoda orgjinale që u mbështetën në traditën e pasur luftarake të popullit dhe që u mbajtën parasysh në format e organizimit ushtarak e shkallën e pajisjes me teknikë luftarake të Forcave Kryengritëse. Forcat Kryengritëse gërshtuan drejt taktikën e luftës në front të rregullt me format e metodat e luftës tradicionale. Taktika u shqua nga aktiviteti, dinamizmi dhe shpirti sulmues. Nëpërmjet goditjeve të befasishme, sulmeve natën, vendosmërisë në luftim, manovrueshmërisë e shfrytëzimit të terrenit, përdorimit me shpirt krijues i mjeteve rrethanore, etj., Forcat Kryengritëse kapërxyen pengesat me tela, shpërthyen pozicionet e fortifikuara dhe zgjidhin detyrën të vështira në luftim. U bënë veçori e taktikës sulmet e pandërprera me forca të kufizuara, që nuk i lanë forcat serbe të merrnin frymë, i mbajtën në panik e në tension të vazhdueshëm nervor dhe u siguruan forcave kryengritëse iniciativën. Në Luftën e Dibrës përdorim të gjerë morën veprimet luftarake mësymëse, por në momente të caktuara u përdorën dhe luftimet mbrojtëse. Taktika e luftimeve mbrojtëse u karakterizua gjithashtu nga qëndrueshmëria, aktiviteti, ndërtimi i kurtheve, pritave etj.

Lufta e Dibrës e viteve 1920-1921 tregoi vitalitetin dhe energjinë luftarake të një populli që u ngrit në këmbë për të mbrojtur me gjak lirinë dhe pavarësinë e vet. Kjo luftë u bë një thesar i paçmuar i traditave luftarake të tij, u trashëgua e u ngrit në një shkallë të lartë nga formacionet partizane të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Këto tradita, kjo përvojë duhet të mësohen e të njihen nga ushtarakët e të gjitha strukturat e sigurisë në interes të rritjes së aftësive luftarake e të përdorimit me mjeshtëri në fushën e luftës të formave e metodave të luftimit sa më të gjalla e më të larmishme.



PROFIL



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

(Në përkujtim të 30 vjetorit të rënies të dëshmorit të Policisë së Shtetit Mirjan Dino Hoxha, i cili ishte lindur më 21.1.1971 dhe ka rënë në mbrojtje të rendit e qetësisë publike më 20.4.1991, përpara ambasadës polake në Tiranë. Polici Mirjan Hoxha ishte nga Levani i Tepelenës dhe që kishte shërbyer në Korçë e më tej në Tiranë. Familja e tij i përket njësisë administrative "Krahës", të Bashkisë Memaliaj në qarkun e Gjirokastrës. Fakt është se edhe pse plotëson tërësisht të gjitha kushtet e kriteret ligjore ish-polici Mirjan Hoxha ende nuk është shpallur dëshmor ashtu sikurse e kërkon ligji i shtetit shqiptar. Bazuar në ligjin nr. 109/2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", në nenin 5, "Kriteret për shpalljen e statusit "Dëshmor i atdheut", pika "j" thotë që: shpallen Dëshmorë të Atdheut "shtetasit shqiptarë, të cilët vriten nga elementë kriminalë për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer, në luftë kundër krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike". Nisur nga të dhënat e vrasjes në krye të detyrës në përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike ish-polici Mirjan Hoxha rënë në krye të detyrës, me dokumente plotësisht të vërtetueshme meriton dhënia e statusit "Dëshmor i atdheut" nga strukturat përgjegjëse të shtetit sikurse është Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut pranë Ministrisë së Mbrojtjes).

Nderimi për të rënë është një detyrim mbarëkombëtar, sepse dëshmorët janë të shenjtëruar dhe të pavdekshëm. Ata jetojnë dhe lartësohen në valët e flamurit shqiptar. Dëshmorët nuk vdesin, kur gjakun e derdhin për Atdheun dhe për flamurin kombëtar. Mirjan Hoxha ishte 20 vjeç në lulen e rinisë, kur tranzicioni shqiptar dhe ndërrimi i sistemeve e gjeti ushtar dhe më tej polic në shërbim të shtetit në detyrën fisnike të ruajtjes së kufijve, por edhe të rendit, sigurisë e qetësisë në kryeqytetin e trazuar shqiptar të asaj kohe. Kërcënimi i situatës së brendshme vinte nga vetë shqiptarët dhe ishte sa i ashpër e brutal aq edhe i paarsyeshëm dhe i palogjikshëm. Detyra e policisë nuk ka ndryshuar. Mirjan Hoxha ishte në kohën dhe vendin e duhur, por forcat e errëta në Shqipëri hakmerreshin me cilindo u delte përpara edhe me policin që i ruante. Mirjani kishte shkuar më parë si ushtar polic në repartin nr. 425 në Korçë dhe më tek në repartin nr. 712 Tiranë, ku shërbimin e kryente pranë ambasadave të huaja. Ka qenë data 20.04.1991, kur tre vetë ndërkohe që ishte në krye të detyrës, përpara ambasadës polake në Tiranë është vrasur pabesisht nga një grup i armatosur. Ka kaluar tre dekada që kur ka rënë për rendin e qetësinë në Shqipëri dhe sot Mirjani do të ishte 50 vjeçar, por jeta e tij u këput në mes nga forca të errëta duke ngeluar memorial kujtimi dhe dëshmor i pashpallur, por familjarët janë në pritje që e drejta e gjakut të derdhur të policit, që ishte gjak i shtetit të vihet në vend. Ishte koha kur ndërronte sistemi, por bijtë e bijat e tij të ndara në kampe pluraliste kishin humbur busullën e orientimit të shqiptarizms. Opozitarizmi ishte keqkuptuar e keqinterpretuar. Gjaku i derdhur i policisë, gjaku i 267 bijëve e bijave më të mirë të policisë vetëm në 30 vjet është i tepërt dhe i pajustificuar për

MIRJAN HOXHA – DËSHMOR I POLICISË SË SHTETIT

vend që kërkon të zhvillojë, përparojë dhe të ketë prosperitet me synime të qarta për një shtet të së drejtës, ku të ketë rend e qetësi të vazhdueshme.

Mbrojtja e jetës qytetare, rendit dhe sigurisë një betim i përhershëm i Policisë së Shtetit

E kishte pritur me kënaqësi ditën e betimit, sepse Ai vinte nga një trevë mençurie, që kishte përkundur në djepe burra të pushkës dhe të penës, të mençurisë dhe të trimërisë. Mirjani ishte burrëruar para kohe, ishte serioz, punëtor dhe i përkushtuar para vështirësive. Kur e përcollën në detyrë e llogaritën në "radhën e burrave" siç e donte zakoni dhe përcjellja ishte një moment i veçantë jo vetëm në familje por edhe për fshatin e tij Levanin dhe krahinën. Pas mobilizimit dhe kryerjes së karantinës i vinte radha betimit. Ai e dinte se, shqiptarët ishin betuar që herët nëpër breza, për pushkë, për këtë tokë, për flamur, për nënën dhe babën, për truallin e të parëve, për atdheun që e kishin pasur amanet brezash edhe në kohët e pushtimeve më të egra. Edhe Mirjani dhe shokët e tij e pritën betimin si zakon brezash, si një traditë të të parëve që betoheshin shëkujve dhe krijonin një atmosferë solemne, që finalizohej me puthjen e flamurit dhe nënshkrimin e tekstit të betimit. Edhe në betimin ushtarak të Mirjan Hoxhës atmosfera në betimin ushtarak ishte solemne sepse atje kishin ardhur autoritete të larta, dhe vendi i betimit ishte një vend i shenjtë si monument i lavdisë së brezave. Pas betimit ushtari, polici, ushtaraku, djemtë nën uniformë në të gjithë nevelet nuk i përkisnin më familjes por në radhë të parë shtetit, Atdheut, kombit. Teksti i betimit, uniformat, armët, marrshet orkestrale ushtarake, himni, besimi në mbajtjen e armëve, flamuri i njësisë, parada ishin elementë që Mirjani rregjistroi në kujtesë sikurse përsëriti fjalë pas fjalë formulën e betimit ushtarak. Kishte kaluar me bindje testet dhe udhëzimet e pjekurisë për detyrimet ndaj Atdheut. Mirjani dhe shokët e tij çdo ushtar-polic morën përgjegjësi të rëndësishme që nga momenti i betimit. Ishte momenti kur zyrtarisht bëhej mbrojtësi i vendit të tij, mbrojtës i kufirit dhe më tej mbrojtës i rendit dhe qetësisë publike. Respektimi i përpiktë i fjalëve të thëna në këtë ditë ishte dhe mbeti lidh për Mirjanin. Ai e njihte mirë ligjin dhe ishte ndërgjegjësuar për shkeljet sado të vogëla të detyrimeve që çonin në dëmtimin e gatishmërisë, interesave të vendit dhe popullit, prandaj betimi i tij ishte betim me zemër: "Betohem se do t'i shërbej me besnikëri Republikës së Shqipërisë; do të jem ushtar besnik i popullit tim, luftëtar i denjë, trim e i disiplinuar, do të jem i gatshëm në çdo kohë e vend dhe nuk do të kursej as jetën time për mbrojtjen e interesave të Atdheut. Betohem"! Dhe në fakt nuk e kurseu jetën dhe gjakun e tij kur u bë barikadë e drejtësisë dhe mbrojtjes së jetës qytetare më 20 prillin e vitit 1991, duke ngeluar në kujtesën e familjes, fshatit Levan, Krahësit të Tepelenës dhe të të gjithë brezave të Policisë së Shtetit shqiptar.

Biografia e dëshmorëve që gjakun e falën për sigurinë e shtetit është shkruar me gjak

Mirjan Dino Hoxha ishte lindur në fshatin Levan të Tepelenës, më 21 janar të vitit 1971. Ai lindi në një familje të thjeshtë dhe me traditë atdhetare e patriotike. Fëmijëria e tij ishte sikurse edhe e bashkëfshatarëve të tjerë. Arsimit fillor e tetë vjeçar nga viti 1977 deri më 1985 e mori në fshatin e tij të lindjes, në Le-



van të Tepelenës në shkollën "Musa Rrapi". Shkollën e Mesme e kreu në qendrën e lokalitetit të tij në Krahës të Tepelenës, në shkollën Mesme të Bashkuar "Adem Alushi" në vitin 1985 deri në vitin 1989, të regjistruar me nr. Amze 409 dhe numër të rregjistrimit të vaxantë nr. 264. Pas përfundimit të Shkollës së Mesme, Mirjani punoi si specialist bujqësie në fshatin e lindjes në Levan për periudhën gushti 1989 deri më qershor 1990. Dëshirat dhe ambicjet ishin të shumta por detyra ndaj shtetit ishte detyrim për të gjithë djemtë shqiptarë. Me fletëthirrje nga autoritetet ushtarake të kohës, Qendrës së Rekrutim – Mobilizimit Tepelenë, Mirjani u thirr ushtar më 4 qershor 1990. Ai shkoi ushtar pranë Repartit Ushtarak Nr. 425 në Korçë, që është edhe e konfirmuar nga Qendra e Rekrutim Mobilizimit të Qarkut Gjirokastrës të konfirmuara nga koloneli Lulëzim Meçi. Pasi kishte bërë karantinën ndërkohë që situata në Tiranë ishte e trazuar dhe nuk po gjente qetësi si rezultat i ndërrimit të sistemit socialist në sistemin demokratik një pjesë e kontigjentit të Korçës transferohen në Tiranë, për të përfunduar sektorin e ruajtjes, qetësisë dhe rendit publik. Kështu duke qenë repart në varësi të Ministrisë së Brendshme pati edhe rishikim të shpejtë të shpërndarjes së forcave të rendit e sigurisë në vend dhe për nevojat emergjente shumica e policëve të repartit të Korës ku shërbente Mirjani u transferuan pranë repartit nr. 712 Tiranë. Fakt është se për prezencën e policit Mirjan Hoxha në Repartin nr. 712 të Tiranës konfirmohet edhe nga një shkresë e lëshuar nga ky repart datë 30 mars të vitit 1991, vetëm pak ditë se të vritej polici Mirjan Hoxha. Shkresa ishte lëshuar si vërtetim për të marrë pjesë në zgjedhjet e para pluraliste shqiptare të datës 30 mars 1991. Gjatë kryerjes së shërbimit policor pranë Ambasadës Polake, më 19 prill 1991 është plagosur rëndë dhe menjëherë ishte dërguar në Spitalin Ushtarak, Tiranë, ku nga të dhënat dokumentare plagëve u ka mbijetuar vetëm një ditë sepse ka ndërruar jetë nga plagët e rënda që kishte marrë më datën 20 prill 1991. Kjo konfirmohet nga dokumentacioni sepse "...polici Mirjan Dino Hoxha ishte shtrua datë 19.04.1991 dhe ndërroi jetë, datë 20.04.1991". Mirjani u vra qëllimisht nga një grup prej tre vetash që ishin inisiatorë dhe në krye të një turme protestuesish të dhunshëm, të cilët synoni destabilizimin e vendit. Në kohë të ndryshme në këtë situatë po në të njejtën periudhë janë tre policë të vrasur dy prej të cilëve janë

shpallur dëshmorë vetëm me arsyen se kanë vdekur menjëherë nga plagët e plumbave ndërsa Mirjani ka ndërruar jetë në spitalë po nga plumbat por 24 orë më vonë. Në një dokument vërtetues të lëshur nga QRM Gjirokastrë, që mban datën 16. 02. 2005 thuhet në mënyrë tekstuale se: "Mirjan Hoxha....është vrasur nga një grup prej tre vetash". Ishte pikërisht kjo ngjarje që është etiketuar si "ngjarja e ambasadave" prill 1991, që bëri që Mirjan Dino Hoxha të humbas jetën në krye të detyrës duke lënë në pikëllim familjarët si dhe kolegët e tij të Policisë së Shtetit. Në kujtesën e brezit të tij ka ngjelur momenti kur Ministria e Rëndit, me urdhër të Ministrit të Rëndit dhe qetësisë publike (ish-Ministër i Brendshëm për kohën ishte Gramoz Ruçi) organizoi ceremoninë e varrimit të ushtarit polic Mirjan Dino Hoxha. Në një kohë tejet të trazuar prindrit e dëshmorit polic (babai i tij Dino Hoxha) nuk pranon, që i biri Mirjani të varroset në varrezat e dëshmorëve, por në gjaknxehtësi e sipër, duke gjykuar se "djalin ja kisha besuar shtetit dhe për detyrën e detyrimin ndaj shtetit", por jo t'ja kthenin të vdekur. Kohët ndryshojnë, por një gjë është fakt dhe e vërtetë se familja e Mirjan Hoxhës parapëlqeu që ceremonia e përcjelljes të bëhej më datë 21.4.1991 në ora 18.30 në fshatin Levan të Tepelenës atje ku ishin gjithë familjarët dhe të dashurit. Për kohën komplekse që kalonte vendi familjarët e deshën birin e tyre pranë në varrezat e fshatit, por nderi i titullit "Dëshmor", kërkon respektim të ligjit të shtetit. Shteti i kohës ishte dorëzuar dhe në ceremoninë e varrimit të policit Mirjan Dino Hoxha mori pjesë, Kompania IV e Repartit Nr. 712 nën drejtimin e Komandanti të Repartit 712, ushtarakut Sefer Pasha. Ushtarakët dhe policët që morën pjesë në këtë ceremoni kanë lënë edhe një shkresë të firmosur prej tyre për një shumë monetare të përcaktuar për familjen e të ndjerit, e policit të Levanit, e dëshmorit të Shqipërisë, të rendit dhe të qetësisë publike.

Nëse shikojmë listën e pjesëmarrësve që me lot në sy përcollën një ndër djemtë dhe shokët e tyre më të mirë. Ata nuk përcollën Mirjanin por një copëz të zemrës së tyre prandaj edhe familjarët e Mirjan Hoxhës nuk i harrojnë të 44 pjesëmarrësit që ju gjenden familjes në ditë gjëme për familjen e tyre siç janë Frederik Nakolli, Nexhip Rexha, Arjan Jaupi, Kozma Qirja, Aleksandër Doshi, Nesim Cenaj, Adi

(Vijon në faqen 9)

PROFIL

Një vit pa mikun e shokun tonë të mrekullueshëm, nga përvoja e të cilit kanë se ç'të mësojnë kuadrot e sotëm

*Nga: Mark Prendi, Ndue Dodbiba,
Bardhok Gjokolaj, Xhelal Marku*

NIKOLL BROZI, I THJESHTË GJER NË MADHËSHTI



Kaloi një vit pa mikun e shokun tonë të mrekullueshëm, Nikoll Brozi, një ish kuadër i njohur në rrethet Mirditë e Kukës. Largimi i tij nga kjo jetë, na preku shumë, sepse ishte një njeri me vlera të shumta njerëzore dhe intelektuale, që la pas një emër të respektuar e të nderuar për të gjithë ata, që e kanë njohur. Ai, sot i mungon jo vetëm familjes së tij, por edhe ne shokëve, që e kishim si lezetin e muhabetit e të humorit, në takimet tona, në bisedat e kafesë së mëngjesit, e kudo tjetër. Kaloi një vit pa Nikollën tonë të dashur e të respektuar dhe ne e ndjejmë shumë mungesën e tij. Ndaj, ne, ish shokët e tij më të afërt: Mark Prendi, Ndue Dodbiba, Bardhok Gjokolaj e Xhelal Marku, vendosëm të shkruajmë diçka për Nikoll Brozin, në shenjë respekti, mirnjohje e konsiderate për të, sepse na ka lënë një vend bosh në karriket e tavolinës tonë, ku takoheshim shpesh.

Nikoll Brozi ka lindur më 20 gusht të vitit 1935, në fshatin Perlat të rrethit të Mirditës. Mësimet e para ai i kreu në vendlindjen e tij dhe më pas u kompletua edhe me arsimin e mesëm e të lartë dhe u bë një kuadër i devotshëm, duke plotësuar me sukses çdo detyrë, që i është ngarkuar. Thuhet, se i miri e ka në gen vënjesën e tij dhe ne bashkohemi me këtë thënie, pasi shpesh përsërisim edhe fjalët: “Më bë baba, të të ngaj”. Dhe si mund të ndodhte ndryshe, me Nikoll Brozin, me një baba fisnik e të mrekullueshëm, si Mark Brozi, që kishte ai? Mark Brozi u martua me Dila Sulejmanin, nga shtëpia e Preng Nikoll Sulejmanit, e njohur në krahinë për mikpritje e bujari. Sigurisht, nga dy prindër të mençur e fisnikë, një djalë i mirë si Nikoll Brozi do të dilte, i cili mori cilësitë më të mira njerëzore të prindërve të

vet. Nikoll Brozi i përkiste gjeneratës së brezit, që mori përsipër rindërtimin e vendit të sapo dalë nga lufta Antifashiste Nacional – Çlirimtare. Ai ishte një kuadër me formim të gjërë dhe integritet të admirueshëm, i aftë dhe i përkushtuar për të bërë realitet çdo detyrë, që i ngarkohej. Ndaj, kudo që punoi, Nikoll Brozit i shkëlqeu puna dhe la pas një emër të mirë. Nikoll Brozi ishte mjeshtër i fjalës dhe i muhabetit, që dinte të komunikonte mirë e bukur me të gjitha nivelet e moshat, ndaj e donin të gjithë atë. Dhe mbi të gjitha, tek Nikoll Brozi shkëlqente thjeshtësia

e kuadrit, që jetonte me hallet e popullit dhe luftonte me të gjitha mundësitë e tij, që t'i ndihmonte ata, t'u zgjidhte çdo kërkesë të drejtë e të ligjshme. Ai ishte një kuadër i përkushtuar e dinjitoz, që fjalën e dhënë do ta çonte deri në fund, duke fituar besimin e njerëzve, se po takove Nikoll Brozin, ke takuar njeriun, që i jep zgjidhje problemit dhe nuk i mban peng hallexhinjtë, me sorollatje burokratike. Ndaj dera e zyrës së tij si drejtues kryesor në rrethin e Kukësit, ishte përherë e mbushur me njerëz, sepse besonin në fjalën e tij dhe në drejtësinë e tij, për të mbështetur njerëzit në nevojë.

Nikoll Brozin e karakterizonte ndërgjegjia e lartë në punë, drejtësia në zgjidhjen e problemeve të popullit dhe këmbëngulja për t'i çuar deri në fund punët e nisura. Ishte një kuadër i guximshëm, për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe nuk u tjetërsua kurrë nga trysnia, cinizmi dhe hipokrizia e kohës, duke ruajtur të paprekur dinjitetin, karakterin dhe vlerat e tjera morale e njerëzore, me të cilat kishte fituar besimin dhe respektin e masës. Ai ishte njeriu, që nuk mund të qëndronte indiferent përballë mosrealizimeve, ishte i guximshëm për të thënë mendimin e tij me kurajo dhe nuk frikësohej nga kostoja e qëndrimit të tij kritik ndaj problemeve, që kishte administrata e rrethit apo ajo e bazës. Nikoll Brozin e karakterizonte pastërtia e figurës së tij moralo-politike dhe edukonte me shembullin e tij personal si kuadër i aftë e korrekt, që burokracinë e konsideronte si armikun më të madh të

punës e të progresit. Ai nuk ishte dogmatik e fanatik dhe njeri i ngurtësuar në pikëpamje e mentalitete, por ishte një kuadër me plot energji pozitive, që me veprimtarinë e tij mbështeste gjithmonë idetë progresive e përparimtare të shoqërisë. Drejtësia dhe sinjeriteti, ishin cilësitë e tij njerëzore, që e shoqëruan gjithë jetën Nikoll Brozin. Dhe për këtë, ai ndjehej përherë krenar, pasi në metodën e tij të punës spikaste mendimi krijues me moton: “Ta fillojmë nga e vogla, për të arritur tek më e madhja”.

Dinamizmi dhe vullti në punë i Nikoll Brozit, ishin modeli më i mirë i punës së një kuadri me përvojë në drejtimin dhe organizimin e veprimtarive në rrethin e Kukësit. Nikolla ishte i dashur me shokët dhe nuk e pamë kurrë të mburrej për arritjet e tij. Edhe pse kapi nivele të larta të punës drejtuese në rrethe, ai mbeti përherë i njëjti Nikoll, i thjeshtë dhe me një komunikim të ngrohtë me këdo. Ai kishte dashuri e respekt të veçantë për kuksianët, me të cilët u përshtat mrekullisht, por ishte dhe plot nostalgji për mirditorët e Mirditën e tij, admironte shumë traditat e bukura dhe burrrërinë mirditase. Nikolla punëshumë dhe bashkëshortja e tij, Liza, ishin edhe familjarë të mirë, që edukuan tek fëmijët e tyre cilësitë më të mira njerëzore. Ndaj, e dëgjonim shpesh Nikoll Brozin të thoshte, se ndjehem krenar me familjen dhe me Lizën, e cila ka një kontribut të veçantë në edukimin e fëmijëve të mi.

Nikolla dhe Liza ishin dhe çifti më ideal, që kishin marrëdhënie korrekte dhe me shumë harmoni e mirkuptim mes tyre. Ata lindën, rritën dhe edukuan pesë fëmijë, tre djem e dy vajza, njëri më i mirë se tjetri: Markun, Agimin, Viktorin, Marien dhe Vjollcën, një pasuri e madhe prindore kjo, për të cilën, Nikolla dhe Liza u përkushtuan me tërë kujdesin e tyre, që ata të shkollohen e të bëhen të dobishëm për familjen dhe për shoqërinë. E rëndësishme është, se fëmijët e çiftit Brozi, u futën me dinjitet në rrugën e jetës dhe po punojnë e jetojnë nën shembullin dhe modelin e prindërve të tyre të mrekullueshëm. Ata e vuajnë shumë mungesën e prindërve të tyre dhe janë shumë të pikëlluar, që nëna e tyre Liza, ka vuajtur gjatë nga një sëmundje, por që nuk i ka munguar për asnjë çast kujdesi dhe shërbimi nga fëmijët dhe bashkëshorti Nikolla, që i kanë qëndruar vazhdimisht pranë, duke e inkurajuar me shpresën se do të shërohet.

Nikoll Brozi ishte një njeri shumë aktiv edhe pas daljes në pension. Ai nuk e ndërpreu veprimtarinë e tij krijuese, shkruajti libra dhe lexonte shumë. Por, fati i keq, sëmundja e COVID-19, e rëndoi dhe u nda nga jeta më 15 nëntor të vitit 2020, duke sjellë dhimbje të madhe dhe lot në familje, tek miqtë dhe shokët e tij. Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, ndodhi edhe fatkeqësia tjetër, pas katër a pesë ditësh ndërroi jetë edhe bashkëshortja, Liza, duke e dyfishuar dhimbjen në familje.

Ne ju shprehim ngushëllimet tona të sinqerta fëmijëve dhe të afërmëve!

Qofshin të paharruar bashkëshortët model, Nikoll Brozi e Liza Brozi!

MIRJAN HOXHA – DËSHMOR I POLICISË SË SHTETIT

(Vijon nga faqja 8)

Lule, Hekuran Xyra, Besnik Shkurti, Gazment Cani, Bekim Radaku, Ferdinnt Laze, Ajan Delli, Ded Rroku, Sadik Ballhysa, Besnik Sulollari, Fatos Kiptiri, Ylber Pepa, Sokol Enia, Enver Sehiti, Agim Ballaxhia, Arben Bira-ku, Bujar Leka, Adrian Ivanaj, Mentor Varosi, Kujtim Istrefi, Granit Bekol-lari, Rushit Belishahu, Besim Sala, Ded Peraj, Gëzim Moçka, Arben Myr-to, Vilson Sulejmani, Bujar Brahushi, Arjan Ferroku, Fatmir Lame, Gëzim Nika, Adi Çipi, Pëllumb Ndreka, Mane Sula, Ilirjan Bakiasi, Partizan Petriti, Lefter Domi, Fatos Mema, Agron Paja, Ferdinand Preka dhe Genc Koka. Këta bij nënash të përballur me rrezikun lanë një pjesë të zemrës në fshatin e shokut të tuaj dëshmor të pashpallur, për paqëndrueshmërinë e strukturave të shtetit të asaj kohe. Megjithëse populli ka një maksimë proverbiale, që “e drejta zhytet por nuk mbytet”. Gjaku i shokut të tij polic, pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit nuk mund të harrohet, por meriton të jetë në piedestal të lavdisë dhe nderimit të kombit shqiptar.

HOMAZH, NDERIM DHE PËRJETËSI NË VLERËSIMIN PËR DËSHMORËT

Biri i Levanit ishte punonjës shembullor i Policisë së Shtetit. Për djalën e policisë, për dëshmorin e orëve të para të një shteti me fizionomi të re është folur

dhe do të flitet, është nderuar dhe janë bërë homazhe duke nderuar përjetësisht yjet pranë Ministrisë së Brendshme, ku çdo yll përfaqëson një dëshmor. Po polici dëshmor Mirjan Hoxha ku e ka vallë yllin dhe a i janë bërë nderimet e plota sikurse gjithë dëshmorët e tjerë. Nderimi i dëshmorëve është një amanet brezash. Aktualisht ish-ushtaraku Sefer Pasha është dukë shkruar një libër të posaçëm pikërisht për dëshmorin polic Mirjan Hoxha. Ndërkohë që përjekjet familjare dhe jo vetëm, nuk kanë rreshtur duke ju drejtuar institucioneve të shtetit, gjykatave dhe prokurorisë për të mësuar të vërtetat dhe misteret e kësaj vrasjeje të hapur të një punonjësi rendi shembullor, që ka rënë në krye të detyrës, sikurse është kërkesa është firmosur prej vëllait të Mirjanit, Baro Dino Hoxha e datës 8.9.2021 drejtuar drejtuesve të Prokurorisë së Shkallës së Parë në Tiranë, ku kërkohet vendimi i Prokurorisë së Tiranës për vrasjen e polic Mirjan Dino Hoxhës më datën 20 prill 1991. Faktikisht nga Këshilli i Qarkut Gjro-kastër, kjo vërtetohet nga një shkresë Nr. 57, datë 07. 09. 2005 drejtuar Prokurorisë së Krimeve të Rënda nënshkruar nga ish-Kryetri Resul Logo, ku kjo prokurori ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 271, datë 14.9.2005. Ky institucion i është drejtuar edhe Prokurorisë Ushtarake me shkresë nr. 217, datë 27.4.2005 dhe konfirmimi është i qartë se: “Mirjan Hoxha...është vrarë nga një grup prej tre vetash”.

Përpjekje të tjera ka edhe nga Shoqata e Historianëve Ushtarakë shqiptarë

në Tiranë, nga Shoqata Atdhetare Kulturorë e Trevës së Krahësit, nga Shoqata e Veteranëve të Tepelenës dhe Dega e Tepelenës e Organizatës për Dëshmorët e LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të Atdheut etj. Një ndërgjegjësim mbarë shoqëror nga shumë struktura dhe organizata. Ndërkohë që ligjërisht bazuar në kriteret logjore në zbatim të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 5, “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i atdheut”, pika “j” thotë: shpallen Dëshmorë të Atdheut, “shtetasit shqiptarë, të cilët vriten nga elementë kriminalë për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer, në luftë kundër krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike”.

Kështu që nisur nga të dhënat e vrasjes në krye të detyrës në përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike ish-policit Mirjan Hoxha meriton plotësisht që t'i jepet statusi “Dëshmor i atdheut” nga strukturat përgjegjëse të shtetit, nga Komisioni Qendror i statusit “Dëshmor i Atdheut”, që funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Pas dhënies së këtij statusi gjithashtu bazuar në ligj eshatrat e dëshmorit Mirjan Hoxha nuk mund të prehen më në varrezat publike të fshatit të tij të lindjes në Levan por në varrezat e dëshmorëve të Tepelenës, ku do të qëndrojnë përjetësisht krahas dëshmorëve të tjerë të atdheut, me mbishkrimin Mirjan Hoxha dëshmor i Atdheut, rënë për rend, qetësi e shtet të sigurtë në prag të vendosjes së demokracisë në Shqipëri.

OPINION

Veriu i Kosovës - fitil baroti për rajonin

Bashkim Hisari

Në vitin që lam pas, Kosova ka bërë përparim të dukshëm në një numër fushash. Progresi është arritur në respektimin e të drejtave të njeriut, sidomos të komuniteteve dhe në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë. Përparim është shënuar në zhvillimin ekonomik, industrial, në bizneset e vogla, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ripërtëritshmërinë e burimeve të energjisë, mbledhjen e detyrimeve të importit si dhe në kontrollin e mjeteve dhe mallrave. Është ngritur mbikëqyrja dhe transparenca e prokurimit publik.

Në shumicën e komunave të Kosovës, procesi i zgjedhjeve lokale u zhvillua në një atmosferë demokratike dhe pa incidente.

LUFTA KUNDËR PANDEMISË COVID 19 PO ZHVILLOHET ME SUKSES.

Në mbledhjen e dy qeverive Shqipëri-Kosovë që u bë në Elbasan më 26 nëntor 2021, u rishikuan 86 marrëveshje të lidhura gjatë takimeve të përbashkëta që janë zhvilluar deri tani dhe u nënshkruan 13 marrëveshje të reja në fushën e ekonomisë, diplomacisë, drejtësisë, shkençës e kulturës që do të krijojnë kushte më të favorshme për të dy anët e kufirit. Në këtë mbledhje, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe i Kosovës, Albin Kurti, u unifikuan me aspiratat shekullore të shqiptarëve për bashkimin e Shqipërisë dhe Kosovës. Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftërave për liri e pavarësi të popullit shqiptar (OBVL) dhe Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionaqlirimtare të Kosovës (OVLANÇ) ishin të parat që kane mbështetur dhe përshëndetur këtë qëndrim.

Megjithatë, Kosova cilësohet si vend "jo i lirë". Qytetarët e Kosovës nuk e kanë liberalizimin e vizave, nuk mund të udhëtojnë pa viza në BE. Korrupsioni dhe mungesa e një sistemi funksional të drejtësisë po vështirsojnë implementimin më efikas të qeverisjes. Evidente janë edhe disa dukuri negative që po dobësojnë institucionet dhe proceset demokratike dhe po gërryejnë besimin në parimet demokratike. Të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi janë edhe papunësia dhe varfëria. Sipas raportit të Bankës Botërore, shkalla e papunësisë në Kosovë është më e lartë në Evropë, 46.2% e popullsisë jeton në varfëri. Bisedimet Prishtinë-Beograd të lehtësuara nga BE për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi kanë hyrë në udhëkryq dhe nuk po japin rezltate konkrete. Dallimet mes palëve janë të theksuara dhe nuk ka përparim për vendosjen e drejtësisë dhe barabarësinë e palëve.



Serbia nuk e njeh dhe nuk respekton faktin politik të pavarësisë së Kosovës. Mungojnë lëvizjet efikase për të vënë në vend drejtësinë për viktimat e luftës së fundit. Edhe 21 vjet pas luftës, familjarët janë në pritje për të kuptuar më shumë për fatin e rreth 1.600 personave të zhdukur. Serbia po përpaket të ndryshoj faktet historike duke mohuar krimet kundër njerëzimit dhe po vazhdonë mendësinë e regjimit të Millosheviqit duke rehabilituar kriminelët e luftës të cilët në Kosovë, kryen masakra me qëllim të zhdukjes së shqiptarëve. Gjatë luftës së fundit në Kosovë u vranë rreth 13.500 njerëz.

Të gjitha këto bashkë me çështjen e qytetit të ndarë të Mitrovicës dhe provokimet e qarqeve ekstremiste serbe në veriun e Kosovës kërkojnë zgjidhje urgjente në dijalogun me Serbin.

Plani i Marti Ahtisarit duhej të jetë bazë për integrimin e veriut të Kosovës, plan ky që përjashton çdo mundësi që veriu të ketë një lloj autonomie të veçantë, mirëpo serbët në veri të Kosovës dhe Beogradi, nuk e respektojnë këtë plan. Kërkojnë implementimin e marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, Që nga periudha e pas luftës 1998/99, zona e veriut të Kosovës paraqet rrezik permanent për qytetarët. Sipas vlersimeve, para luftës, në këtë zonë kanë jetuar mbi 300.000 banorë, nga të cilët rreth 43.000 ishin serbë që kryesisht banonin në Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe në pjesën veriore të Mitrovicës. Në vitin 1991, në Kosovë ka pasur gjithësejt 194.190 banorë serbë. Aktualisht, ky numër është dukshëm më i vogël. Shqiptarët, në vendbanimet e tyre në këtë zonë, ku ishin shumicë, gjatë kohës së konflikteve kanë pësuar dëme të rënda. Rreth 65% të tyre u grabitën, pronat e tyre u shkatërruan, u dëbuan dhe ishin viktimat të krimeve të tmerreshme.

Ndërkaq, vendbanimet serbe mbetën pothuajse të paprekura. Një numër i vogël i shqiptarëve që sot jetojnë në fshatra, janë të izoluar nën presionin e vazhdueshëm të ekstremistëve serbë. Prona dhe siguria e tyre është e rrezikuar. Qendra kryesore e kësaj zone, Mitrovica, ka mbetur qytet i ndarë, me vijën e ndarjes mes shumicës shqiptare në jug dhe asaj serbe në veri përgjatë lumit Ibër. Ura kryesore mbi lumë ka mbetur një

pikë e ndezur për shumë incidente dhe është një simbol i ndarjes etnike të Kosovës.

Pas bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, kur forcat ndërkombëtare hyrën në Kosovë dhe shqiptarët e dëbuar filluan të kthehen, popullsia serbe, bashkë me serbët të ikur nga vendbanimet tjera të Kosovës të udhëhequr nga pjesëtarë e ushtrisë, policisë dhe paramilitarë serbë nga frika për shkak të krimeve të kryera, menjëherë organizuan të ashtuquajturat "rojet e urës" dhe policinë. Ngritën barrikada dhe krijuan strukturat paralele në fushën e sigurisë, gjykatave, çështjeve pronësore, arsimi, kujdesit shëndetësor, lëshimit të dokumenteve në Kosovë, Qendrën Koordinuese për Kosovën dhe Zyrën për Kosovë e Metohi në kuadër të të cilave veprojnë edhe departamentet për të zhvendosurit, këthimin e serbëve në Kosovë, ndihmë humanitare, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, për administratën civile, rindërtim dhe zhvillim ekonomik, informimetj. Këto struktura të vetëshpallura që janë drejtpërdrejt përgjegjëse dhe nën kontrollin e plotë të Beogradit, nuk kanë mandate me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, por prapëseprapë veprojnë nën autoritetin e qeverisë serbe.

Në veri të Kosovës, e sidomos në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, njeriu nuk mund të vërej pothuaj asgjë kosovare apo shqiptare. Në objektet dhe rrugët kryesore janë të vendosur vetëm flamujt shtetëror dhe partijkak serb dhe parulla nacionaliste të shkruara në gjuhën serbe me alfabetin qirilik. Postera me portretet e kriminelëve të luftës Slobodan Millosheviç, Ratko Mlladiç dhe Vojislav Sheshel, akoma qëndrojnë në fasadat e pallateve në rrugën kryesore. Rrugët janë të emërtuara me emrat e personave që personifikojnë nazmin serb dhe glorifikojnë kombin e tyre. Funksiojnë bankat dhe posta e Serbisë kurse në qarkullim është monedha serbe dinarë. Serbët në veri nuk paguajnë taksat e shërbimet komunale. Që nga përfundimi i luftës, më 1999, banorët e veriut të Kosovës nuk i kanë paguar faturat e energjisë, edhe pse janë furnizuar nga Kosova. Gjatë një viti, ata shpenzojnë energji që kushton rreth 12 milionë euro. Njëri ndër të rrallët nga komu-

niteti jo serb N. J., që jeton në veri thotë: -"këtu kam një ndjenjë fizike dhe shpirtërore se jetoj në një shtet të huaj. Nuk kam siguri. Në pjesën jugore të Mitrovicës nuk mund të lëvizim lirisht. Në urën mbi lumin Ibër, serbët kanë vendosur një traktor me zhavor dhe kanë ndërtuar një mur. Jam në një gjendje të vështirë, çare nuk e kam pasi tërë pasurin e kam këtu".

Krimi i organizuar, trafikimi i mallrave, parave, narkotikëve dhe armëve në veri të Kosovës është zhvilluar pa ndonjë pengesë serioze. Në Raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Thesarit, theksohet se Zvonko Veselinoviq dhe grupi i tij famëkeq, janë organizatorët kryesorë të këtyre veprave. Ky grup ka ndihmuar subjektin kryesor politik të serbëve në Kosovë "Srpska Lista" (Lista Serbe), që të fitonte zgjedhjet e vitit 2017, ndërsa në këmbim të saj, ata dhe bizneset e tyre, të kryenin aktivitetet të paligjshme pa ndërhyrjen e autoriteteve serbe. Po ashtu, duke ndihmuar Listën Serbe, grupi shpërblehej me kontrata në rregullimin e infrastrukturës. Veselinoviq bashkë me bashkëpuntorë të grupit kriminel Milan Radoičiq, (nënkryetar i Listës serbe, Zheljko Bojiq dhe Marko Rosiq, janë akuzuar edhe për vrasjen e liderit të partis Sloboda, Demokratija, Pravda (Liri, Demokraci, Drejtësi) Oliver Ivanoviq.

Në veri të Kosovës, tensionet, lëvizjet e dhunëshme, madje edhe kërcënimet për luftë po vazhdojnë dhe janë dukuri të përditëshme. Tabloidët serbë, në vazhdimësi u "biejnë daullave" se janë "momentet vendimtare për fatin e kombit", dhe se serbët duhet të dërgojnë tanket në Kosovë për të "mbrojtur token e shejtë" të tyre. Atmosfera jashtëzakonisht e tensionuar u krijua pas vendimit të Qeverisë Kurti për zbatimin e reciprocitetit që veturat me targa serbe në Kosovë duhet të vendosin targa të përkohëshme të Kosovës sepse, Serbia nuk i lejonë ato me targa të Kosovës në territorin e saj, Pastaj, serbët në kufi vendosën barikada dhe bllokada. Presidenti i Serbisë, Vuçiq, e ngriti në pikën më të lartë gatishmërinë e trupave ushtrake në garnizonet kufitare. Agresivisht dërgoi në kufi me Kosovën aeroplanë Mig 29, bombardues Orao, helikopterë Mi 35, tanke T72, M84, autobllinda, ush-

(Vijon në faqen 10)

LIBRI

Kujtim Boriçi dhe Nuri Çuni, një libër me vlera për apostullin dhe bilbilin e shqiptarizms

NAIM FRASHËRI – PROFETI I BASHKIMIT RRETH ATDHEUT

SHPENDI TOPOLLAJ

Duke u pajtuar plotësisht me atë mendimin e mençur se shoqëria njerëzore ka nevojë për poetët, ashtu sikurse nata për yjet, po të kemi parasysh kohën kur jetoj, rolin që luajti dhe ndikimin që pati Naim Frashëri, në gjithë zhvillimet e formimit atdhetar të popullit tonë pa dallim feje a krahine, pa frikë mund të themi se ai qe shumë më tepër se kaq. Pastaj, po të shohim se ai me fjalën e tij të magjishme, dhe himnet që si askush tjetër qendisi për bukuritë e Shqipërisë tonë, çoi peshë zemrat e tyre, që bashkë me përpjekjet e burrave të tjerë të shquar finalizuan me fitimin e pavarësisë kombëtare, por se edhe sot e kësaj dite mbeti jo thjeshtë ai që i ngriti vetes si Horaci një monument më të fortë se tunxhi, por qiriri i pashuar, më i çuditshëm dhe më rrezatues për mbi 120 vjet me radhë, Naimi duhet konsideruar si Ylli ynë Polari, figura nga më përfaqësueset e vlerave dhe aspiratave të popullit tonë. Sa herë e kujtojmë e na duhet të flasim për gjithësa ai bëri, krahas krenarisë të ligjshme që ndiejmë, sepse na duket vetja




i vogël e i pafuqishëm dhe na bëhet se ai do të kapërcejë modestinë e thjeshtësinë e tij karakteristike dhe do të përsërisë ato fjalët e njohura të Alphonse de Lamartinit se: “Vetëm Zoti mund të më flasë mbi varr”. Prandaj, janë për t’u përgëzuar dy autorët e nderuar Kujtim Boriçi e Nuri

Çuni, që të mbështetur nga shkëlqesia e tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, e trajtuan universin naiminan në këtë libër kaq dinjitoz. Naim Frashëri ndofta nuk zuri armë me dorë, sido që ish mik i ngushtë kapedanësh e luftëtarësh të shquar, por është ashtu sikurse shprehet nobelisti Odisea Elitis se “Poezia nuk mund të ndryshojë botën, siç mund të bëjë veprimi, por poezia mund të ndryshojë ndërgjegjet e njerëzve, të cilët me veprimet e tyre mund të ndryshojnë botën”. Autorët me të drejtë i kanë mëshuar faktit se Naimi drejtohej në qëndrimet dhe krijimtarinë e tij nga mësimet dhe idetë e bektashizmit. Ashtu si fetë e tjera, bektashizmi ka dhënë prova mjaft elokumente të besnikërisë dhe mbrojtjes së çështjes kombëtare. Mjaft të shohim një foto ilustruese në libër, të 2 qershorit të vitit 1937, kur vinin për t’u prehur në vendlindje eshtrat e Bilbilit të Shqipërisë, dhe do vini re sesi i prijnë kortezhit për ta përcjellë e nderuar atë, krahas kryegjyshit bektashian edhe hierarkët e feve muslimane, katolike dhe ortodokse, gjë që e kemi parë përherë, deri tek ai demonstrimi kup-timplotë në bulevardin e Parisit. Dhe mendja të shkon menjëherë te politikanët tanë arrivistë që edhe për problemet madhore të Kombit, do grinden e shahen pa pikën e gajles, pa menduar fare se kujt i intereson përçarja deri në armiqësi mes tyre. Ne jetojmë në këtë realitet dhe qoftë si qytetarë, qoftë si intelektualë e ndiejmë përditë se këshillat e urta të asaj trashëgimie të pasur që të parët tanë si Naim Frashëri na lanë, ata i kanë hedhur pas krahëve.

Vendin e kanë lënë në dorë të të huajve, a thua se do të gjenden naivë që të besojnë absurdin se malet e Shqipërisë, lisat e gjatë, bregoret bukuroshe dhe lumenjtë tanë të kulluar, i duan ata më shumë se vetë ne shqiptarët. Këta sillen, si të ishin zot në shtëpinë tonë dhe s’kanë faj, pasi çelsat vetë ua kemi dhënë, dhe Shakespeare thosh se një dënim që zgjidhet me vullnet të lirë është gjithmonë i drejtë. Po pak turp

duhet të na vijë; ç’thotë bota për ne e ç’do të thotë historia nesër? A nuk del i qartë si drita e diellit qëndrimi burrëror i Naim Frashërit tek ai rrëfimi brilant i profesor Nasho Jorgaqit që në gojën e xha Baftjarit nga Leskoviku vë fjalët se ai edhe pse ndiqej nga spiunët e Abdyl Hamitit, përsëri nuk pushonte së foluri për mëmëdheun e tij? Le të kujtojmë të vëllanë, Samiun, dijetarin e pashoq kur shkruante “Shqipëtarëtë gjithnjë për botën, e kurrë për vetëhe”. Ata, vëllezërit e pavdekshëm Frashëri e mendonin se Shqipërinë do e bënëin djemtë dhe vajzat e veta dhe jo të tjerët, të cilët vetëm kanë përfutur nga munda, djersa dhe gjaku ynë, siç bënë poshtërsisht me Kosovë e Çamëri. Është kjo arsyeja që miku im i ndjerë Moikom Zeqo, në studimin e tij kryesisht rreth bektashizmit, e quan Naimin jo vetëm Profet të së ardhmes, por edhe konstruktorin e një religjioni sinkretik, pra përbashkues dhe jo të ndarë, e ca më shumë të nënshtruar. Për më tepër, autorët e këtij libri janë kujdesur që kjo frymë të përshkojë të gjitha shkrimet e këtij libri. Ata që do e lexojnë, duhet edhe të reflektojnë, se kjo është në interes të të sotmes dhe të së ardhmes tonë. Vetëm kështu do jemi të sigurt kur ta mendojmë Naim Frashërin tonë, në të pesë varrimet e tij, njësoj të denjë për amanetin që la Hajnri Hajne se: “As vetë s’e di, në se e meritoj, që kur të vdes, arkivolin të ma zbukurojnë me kurora dafinash.

Ama, në të duhet vënë shpata, sepse kam qenë ushtar guximtar në luftën për çlirimin e njerëzimit”. Në mbyllje, nuk është shumë etike, por më duhet të kujtoj fjalët e Stenlej Kabrikut që veprimet e shteteve të mëdha i quante prej gangsterësh dhe ato të shteteve të vogla, prej prostitute. Ne nuk kemi pse të pranojmë këtë damkën e fundit, pasi jemi stërnipër të dalë nga tehu i shpatës së Gjergj Kastriotit dhe nipër të brumosur me dritën e flakës së penës të Naim Frashërit.



Veriu i Kosovës - fitil baroti për rajonin

(Vijon nga faqja 9)

tri e xhandarmëri. Këto provokime të përcjellura edhe me ultimatum, popullata shqiptare nuk mund të interpretonte vetëm si një teatër absurditeti të kërcënimeve me armë boshe, por i trajtonte si fitil baroti që rrezikon tërë rajonin.

Bisedimet për normalizimin e marrëdhënive Kosovë - Serbi, Marrëveshja për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, strukturat paralele serbe në veri të Kosovës, mosrespektimi i ligjit dhe krimi i organizuar, mbeten sfidat kryesore që në të ardhmen e presin Kosovën.

Qeveria e Kosovës dhe ajo e Sërbisë, dialogun duhet ta trajtojnë si një proces historik i cili ka vlerë jo vetëm në funksion të integritetit në BE, por një çështje e domosdashedme që mund të përmirësojë besimin në mes të dy palëve të kundërta për të arritur një marrëveshje për normalizim të plotë të marrëdhënive dhe për arritjes e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse.

Marrëveshja për Asociacionin e komunave serbe që u nënshkrua në nguti në Bruksel nga premtimet të paralizuar për liberalizimin e vizave dhe kundër vullnetit të popullatës shumicë, ishte kundër frymës kushtetuese, integritetit territorial dhe kërcënim për sovranitetin e Kosovës. Thirrjet dhe presionet nga Serbia dhe përfaqësues të ndryshëm ndërkombëtar për zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Asocia-

cionit me kompetenca substanciale ekzekutive, është eksperiment dhe thirrje për paralizim të shtetit të Kosovës. Ndaj, autoritetet e Kosovës me plotë të drejtë kanë deklaruar se Asociacioni do të themelohet në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, dhe pas arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me njohje dhe respektim politik e faktik të pavarësisë së Kosovës.

Por, autoritetet e Beogradit dhe subjekti politik Lista Serbe, që në Kuvendin e Kosovës numëron dhjetë deputetë, kanë pritje të mëdha dhe insistojnë që Asociacioni me funksionimin e tij me kompetenca ekzekutive të formohet menjëherë dhe që kjo çështje të jetë temë për negociim në kuadër të dialogut në Bruksel.

Në fjalimin vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani tha se Serbia ka pretendime të qarta territoriale ndaj Kosovës. “Serbia duhet të heqë dorë nga tendencat destabilizuese në veri, nga presioni ndaj qytetarëve serbë të Kosovës, si dhe nga përkrahja e strukturave ilegale, sikurse edhe të heqë dorë nga politikat agresive ndaj fqinjëve të saj. Dialogu nuk është dhe nuk do të lejojë asnjëherë që të shndërrohet në dialog për statusin, për territorin, për funksionalitetin e brendshëm e për rendin kushtetues të vendit tone” tha presidentja Osmani dhe shtoi se statusi i Kosovës është vendosur njëherë e përgjithmonë, në përputhje me vullnetin e popullit të saj për pavarësi.

FESTIVE

Gëzuar Vitin e Ri 2022!

Kryesia e OBVL-së dhe Redaksia e gazetës "VETERANI", urojnë veteranët, pasardhësit dhe familjet e tyre:

Gëzuar Vitin e Ri 2022!

Le të jetë 2022 viti i krijimit të Federatës Shqiptare të Veteranëve, ku në të të aderojnë: OBVL dhe Organizatat e Veteranëve të LANÇ të Shqipërisë dhe të Kosovës, si pararendëse të bashkimit kombëtar aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e dy shteteve tona dhe të hapësirës mbarëshqiptare në botë.

Urojmë që ky vit të jetë shpresëdhënës për realizimin e aspiratave tona; të na japë forcën dhe kurajën për të përballuar sfidat e kohës...

